



**QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN  
QENDRA AULONA VLORE**

Adresa: Lagja 29 Nentori, Rruga Dede A. Amataj, <http://acpd.org.al/> Tel: 033224531

---

**RAPORT  
VLERËSIMI I KOMUNITETIT PER QEVERISJEN LOKALE**

**Ne Njesite Administrative:**

**ORIKUM, NOVOSELË, QENDËR, SHUSHICË**

**Në kuadër të projektit: “Gratë dhe vajzat e zonave rurale- faktorë ndryshimi në komunitet”**

**SHTATOR- NËNTOR 2017**

**Mbeshtetur nga qeveria suedeze:**



**FALENDERIME:**

Qendra Aulona Vlorë i shpreh mirënjohje të gjithë pjesëmarrësve banorë dhe zyrtarë vendorë, të zgjedhur dhe të emëruar, që jetojnë dhe punojnë si pjesëtarë të komunitetit të Bashkisë Vlorë në njesitë administrative: Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Gjithashtu falenderime shprehim edhe në drejtim të financuesit të projektit “Gratë dhe vajzat e zonave rurale- faktorë ndryshimi në komunitet” Qendrës Olof Palme International Center dhe qeverise suedeze, që mundësoi vlerësimin e komunitetit për qeverisjen vendore per vitet 2014 dhe 2017. Një falenderim i vecantë shkon për të gjithë bashkëpunëtorët e ngushtë të projektit, individë dhe institucione, shoqata dhe agjenci ndërkombëtare që kanë mbështetur përpjekjet e qendrës sonë për të përmbushur misionin për nxitjen dhe respektimin e të drejtave të vajzave dhe grave ne zonën e Vlorës. Gjithashtu, falenderojmë ekspertin e çështjeve të barazisë gjinore znj. Meri Poni që ndihmoi në shkrimin e këtij raporti.

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

<b>I. HYRJE .....</b>	<b>4</b>
1.1. Përmbledhje e raportit .....	4
1.2. Synops i vlerësimeve .....	6
<b>II. METODOLOGJIA .....</b>	<b>8</b>
2.1. Fokus grupet .....	11
2.3. Debatet ballafaqese .....	12
2.4. Shfletimi i dokumentacionit zyrtar .....	12
2.5. Lista e veprimtarive të projektit .....	14
<b>III. REZULTATET E VLERËSIMIT .....</b>	<b>15</b>
3.1. Shërbimet publike: cilësia dhe efica .....	15
3.2. Demokracia vendore dhe mirëqeverisja: pjesëmarrja e grave .....	25
3.3. Zhvillimi ekonomik vendor .....	27
3.4. Të drejtat e grave .....	34
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>38</b>
4.1. Gjetjet e vlerësimit .....	38
4.2. Rekomandimet .....	43
<b>V. SHTOJCAT .....</b>	<b>45</b>
A. Skeda e Vlerësimit (SCORE CARDS) .....	45

## I. HYRJE

### 1.1. Përmbledhje e raportit

Në qershor 2015, Shqipëria organizoi zgjedhjet për qeverisjen vendore sipas hartës së re të ndarjes territoriale<sup>1</sup> që e organizon vendin në 61 bashki, prej të cilave dolën organet drejtuese të pushtetit vendor: kryesitë dhe këshillat vendore për çdo bashki. Komunitat e dikurshme janë shndërruar në njësi administrative të bashkive, gjë që ka ndikuar në shtimin e popullsisë për bashkitë e reja dhe në shtimin e kërkesave nga ana e banorëve të njësive të shtuara bashkive. Në kuadër të rritjes së pjesëmarrjes qytetare në hartimin e politikave vendore dhe forcimit të qeverisjes së mirë, Qendra Aulona po zbaton projektin “Gratë dhe vajzat e zonave rurale - faktorë ndryshimi në komunitet” i cili synon identifikimin e nevojave të komunitetit, në lidhje me shërbimet vendore, dhe servirjen e tyre të zgjedhurve vendorë, në mënyrë që ata të përfshijnë në politikën dhe buxhetin vendor kërkesat prioritare të komunitetit, përfshirë ato të vajzave dhe grave. Rezultatet e vlerësimeve të projektit u vlejné edhe të zgjedhurve aktuale të qeverisjes vendore, të cilët e përfundojnë mandatin në qershor 2019.

Ky raport mbulon zbatimin e veprimtarive dhe arritjen e objektivave të projektit për vlerësimin e punës së qeverisjes vendore nga ana e komunitetit që u krye përmes sistemit të pikëve (SCORE CARDS). Projekti u realizua në bashkëpunim njësitë administrative: Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë, të Bashkisë Vlorë<sup>2</sup>. Shushica u shtua në projekt pas ndarjes së re territoriale pasi është njëra prej njësive vendore që iu bashkëngjiti bashkisë Vlorë pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Raporti reflekton veprimtaritë vlerësuese të kryera përgjatë periudhës tremujore: 2 shtator – 30 nëntor 2017, të ndërmarra nga Qendra Aulona Vlorë, në bashkëpunim me komunitetin dhe njësitë vendore Orikum,

---

<sup>1</sup> Ligji 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>2</sup> Me miratimin e Ligjit të ri 115/2014, Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative të cilat janë : Vlorë, Orikum, Novoselë, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjese e qarkut Vlorë. Bashkia e re ka nën administrim dy qytete, Vlorë dhe Orikum si edhe 37 fshatra. Spas Gjendjes Civile, me bashkimin e njësive administrative, bashkia e re Vlorë ka 194.147 banorë dhe sipërfaqe 616.65 km<sup>2</sup> me densitet 314.73 banorë/km<sup>2</sup>. Popullsia e bashkisë së vjetër Vlorë ka pësuar rritje krahasuar me atë të njësive administrative Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë, kryesisht prej migrimit të brendshëm të popullsisë së njësive rurale drejt qytetit të Vlorës. Sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile, qyteti i Vlorës përfaqëson 71% të popullsisë urbane, ndërsa popullsia rurale prej 29% banon në njësive administrative Novosele, Qendër dhe Shushicë. Orikumi ka një përzierje të popullsisë rurale me atë urbane.

Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Vlerësimi bën edhe një krahasim mes dy periudhave 2014 dhe 2017, për të parë nëse ka pasur ndryshime pozitive në lidhje me mirqeverisjen vendore dhe pjesëmarrjen e publikut në të. Pra elementët e shtuar vlerësimit të qeverisjes së komunitetit për qeverisjen vendore janë 2: e para, është shtuar për vlerësim edhe një njësi vendore, njësi administrative Shushicë në listën e njësive ekzistuese, Orikum, Novoselë dhe Qendër; dhe e dyta, është bërë një krahasim në kohë mes dy periudhave, para (krahasimi i vitit 2014) dhe pas zgjedhjeve të vitit 2015 që përkon me ndarjen e re territoriale administrative që i bashkëngjiti bashkisë Vlorë edhe 4 njësitë administrative Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë (krahasimi i vitit 2017).

Projekti synon të vendosë një mekanizëm dialogu të vazhdueshëm mes komunitetit dhe njësive të qeverisjes vendore, në bazë të sistemit të pikëzimit të vlerësimit të komunitetit për punë e qeverisjes vendore (VKQ). Qëllimi i projektit është të nxisë dhe monitorojë zbatimin e ligjit për barazinë gjinore dhe të ndihmojë njësitë vendore të planifikojnë dhe buxhetojnë programin e barazisë gjinore në nivel vendor. Projekti synon ta arrijë këtë qëllim përmes bashkëpunimit me komunitetin dhe pushtetin vendor, në vijim të veprimtarive të deritanishme të ndërmarra për vlerësimin e qeverisjes vendore. Projekti synon gjithashtu ta përdorë mekanizmin e dialogut komunitet-qeveri vendore edhe në të ardhmen për të ndihmuar njësitë vendore të përmbushin kërkesat ligjore që rrjedhin nga legjislacioni vendas dhe konventat ndërkombetare në fushën e të drejtave të grave si dhe të përmbushin detyrimet për nxitjen dhe respektimin e të drejtave të vajzave dhe grave. Qëllimi i këtij dialogu është të ngrejë kapacitetin e qeverisjes vendore për përgjigje institucionale ndaj nevojave të komunitetit. Për këtë qëllim, organizata zbatuese e projektit, Qendra Aulona Vlorë organizoi një sërë veprimtarish për vlerësimin e nevojave prioritare të komunitetit dhe vlerësimin e përgjigjes institucionale të qeverisjes vendore ndaj këtyre nevojave. Veprimtaritë përfshijnë takime me komunitetin, me pushtetin vendor dhe takime ballafaqese mes të dyja grupeve për të vendosur një urë komunikimi për bashkëpunim të mëtejshëm.

Në vijim të veprimtarive të përmbledhura në këtë raport, rezultatet e vlerësimeve do të prezantohen në një takim për pjesëmarrësit në vlerësim, për publikun dhe autoritetet vendore. Rezultatet e këtij vlerësimi do të mund t'u shërbejnë organeve të zgjedhura dhe administratës së njësive vendore për të përfshirë në strategjitë e tyre të zhvillimit socio-ekonomik edhe nevojat e vajzave dhe grave. Bazuar në prioritetet e komunitetit, qeverisjet vendore mund të prioritarizojnë listën e nevojave dhe të mendojnë për zgjidhjen institucionale të tyre. Gjithashtu Qendra Aulona do të vazhdojë ta mbajë aktiv mekanizmin

e dialogut “komunitet – qeveri vendore” për të dhënë kontribut në zgjidhjen e problemeve të vajzave dhe grave. Në vijim, Qendra Aulona do të ofrojë ndihmesë në rritjen e kapacitetit të vajzave dhe grave të zonës së Vlorës për aktivizim politik dhe pjesëmarrje në vendimarrjen publike në vitet në vazhdim.

## *1.2. Synops i vlerësimeve*

Në kuadër të projektit u organizuan **12 takime** vlerësuese ku u aktivizuan **250 pjesëmarrës**, prej të cilëve 40 përfaqësues të pushtetit vendor dhe 210 përfaqësues të komunitetit nga NJA Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Qendra Aulona organizoi 4 fokus grupe me komunitetin, 4 fokus grupe me pushtetin vendor dhe 4 takime ballafaqese me të dyja grupet. Në secilën njësi vendore u organizuan 3 takime, nga të cilat: 1 fokus grup me komunitetin, 1 fokus grup me pushtetin vendor dhe nga 1 takim ballafaques mes të dyjave.

Aksesi dhe cilësia e shërbimeve vlerësohen nga komuniteti njësoj si në qeverisjen e shkuar vendore, madje edhe me përmirësime, ndërsa zyrtarët janë më të pakënaqur se banorët për shkak të centralizimit të kompetencave vendore tek bashkia e madhe Vlorë. Cilësia e **shërbimeve publike** me ndikim në cilësinë e jetës së banorëve paraqet mungesa të theksuara në shumë drejtime. Një pjesë e fshatrave vuajnë mungesën e furnizimit të rregullt me ujë. Ndërsa cilësia e ujit të pijshëm është e ulët si për zonën urbane edhe për atë rurale, pasi rrjetet e shpërndarjes janë të amortizuara, sistemi i kanalizimit të ujrave të zeza dhe kanalizimet për kullim nuk mirëmbahen. Rreshjet e shumta në vjeshtë dhe dimër nxjerrin lumin jashtë shtratit. Hidrovori nuk funksionon dhe një pjesë e tokave janë përmbytur. Gjendja e rrugëve nacionale, ndër-qytetëse dhe ndër-fshatëse është relativisht e mirë si pasojë e investimeve publike në rrjetin e rrugëve, por rrugët dytësore në fshatra vazhdojnë të mbeten të pashtruara. Gjendja e ndriçimit të rrugëve në bashki dhe komuna është relativisht e mirë si pasojë e mirëmbajtjes së sistemit të ndriçimit nga pushteti vendor dhe pagesave të banorëve, por në disa fshatra kryesisht në ato që nuk paguajnë nuk ka ndriçim publik. Menaxhimi i mbetjeve inerte dhe asgjësimi i plehrave janë një tjetër problematikë e dalë gjatë vlerësimit, pasi edhe pse ka patur investime dhe kontraktim të shërbimit privat për pastrimin dhe grumbullimin e plehrave nga ana e njësive vendore, ka pjesë të territorit të bashkisë dhe komunave që nuk mbulohen nga ky shërbim në mënyrë të rregullt. Gjithashtu, problem mbetet edhe asgjësimi i plehrave, djegja e të cilave pranë buzës së lumenjve, në periferi të zonave të banuara ndot ajrin dhe ujin. Përveç bashkisë së Orikumit ku ndodhet një park

shlodhës me një kënd të vogël lojnash, në asnjë komunë dhe fshat nuk ka parqe shlodhëse dhe hapësira të blerta për përdorim nga banorët.

Përsa i përket politikave vendore për **përmirësimin e gjendjes ekonomike**, u ngritën një sërë treguesish si: gjendja e përkujdesit social për të vegjlit, gjendja e shërbimit arsimor, ndihma ekonomike për gratë në nevojë, nxitja e punësimit të vajzave dhe grave, gjendja ekonomike e zonës dhe shërbimet vendore për formimin profesional. Nga vlerësimi rezulton se në asnjë njësi vendore nuk ekzistojnë çerdhet dhe se nënat me fëmijë të vegjël e kanë të pamundur të punësohen ose të ruajnë marrëdhënien e punës për shkak të mungesës së përkujdesit publik. Gjendja e infrastrukturës së kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare është përmirësuar si pasojë e investimeve publike në lysterjen e ndërtesave dhe rregullimeve të pjesëshme, por kushtet brenda këtyre institucioneve janë të papërshtatshme për qëndrimin e fëmijëve pasi ka probleme me sigurimin e shërbimeve elementare si uji dhe higjena. Banjot janë në kushte jo të mira higjeno-sanitare.

Gratë e papuna përfitojnë kurse formimi profesional falas nga qendra e formimit profesional dhe iu mbulohen shpenzimet e transportit për të ndjekur kurset. Gratë kryefamiljare të papuna përfitojnë ndihmë ekonomike. **Përfaqësimi politik** i grave në strukturat vendimmarëse është përmirësuar në krahasim me mandatin e shkuar. Përveçse në Shushicë, ku vlerësimi i komunitetit për përfaqësim të balancuar gjinor është negativ, në njësitë e tjera komuniteti shprehet më i kënaqur.

**Dhuna në familje** përbën një problem të mprehtë për shoqërinë shqiptare dhe u shtrua për vlerësim nga komuniteti. Në asnjërën prej njësive vendore nuk ka struktura të posaçme të trajtimit të dukurisë së dhunës në familje. Informacioni për referimin e viktimave të dhunës në zinxirin e shërbimeve psiko-mjeko-ligjore jepet nga administratori shoqëror ose nga shoqëria civile që punon për mbrojtjen e grave në Vlorë, qendra Aulona dhe Vatra.

## II. METODOLOGJIA

Vlersimi i Komunitetit për Qeverisjen (VKQ) në njësitë administrative: Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë, të Bashkisë Vlorë u shtri përgjatë periudhës 2015-2017, që përkon me dy vitet e para të qeverisjes vendore të dalë pas zgjedhjeve administrative të qershorit të vitit 2015. Ky vlersim është në vazhden e një vlersimi të mëparshëm të kryer në vitin 2014, para zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Gjetjet nga vlerësimi i vitit 2014 shërbyen për të orientuar programet e reja elektorale të kandidatëve për zgjedhjet vendore të vitit 2015, që mbajnë mandatin aktual katërvjeçar 2015-2019. Rekomandimet e qytetarëve të dala nga vlerësimi i vitit 2014 përbëjnë bazën e punës së bashkisë së re Vlorë.

Risia e zgjedhjeve të vitit 2015 nuk shënon vetëm ndryshim e konfigurimit të këshillit dhe kryesisë së bashkisë Vlorë, por edhe ndryshim të konfigurimit të qeverisjes vendore nga dy bashki dikur (Vlorë dhe Orikum) dhe tre komuna (Novosele, Qender dhe Shushicë) në një bashki të madhe (Vlorë) që përfshin brenda territorit administrativ tashmë si njësi administrative: Orikumin, Novoselën, Qendrën dhe Shushicën. Prandaj vlerësimi i qeverisjes për periudhën 2015-2017, përveç nivelit të kënaqësisë që banorët shprehin për qeverisjen aktuale (mandat 2015-2019), shpreh edhe një krahasim të këtij niveli me atë të viti 2014, për qeverisjen e shkuar vendore (2011-2015).

Procesi i VKQ u zhvillua në disa faza: (i) vlerësimi nga komuniteti, (ii) vlerësimi nga organet e pushtetit vendor, (iii) ballafaqimi mes komunitetit dhe zyrtarëve të njësive administrative; dhe (iv) organizimi i nja takimi me njësitë vendore për t'iu referuar gjetjet e vlerësimit. Në fazën e parë u nxorrën nevojat prioritare të komunitetit, duke pyetur burra dhe gra në të 4 njësitë administrative, përmes fokus grupeve që u organizuan për këtë qëllim. Përveç sqarimeve në lidhje më problematikën e shkaktuar nga ndarja administrative territoriale (aspektet pozitive dhe negative të reformës për aksesin ndaj shërbimëve të bashkisë), u vlerësuan edhe problemet e komunitetit sipas sistemit të pikëzimit (Score Cards). Në fazën e dytë u organizua vlerësimi me fokus grupe prej zyrtarëve vendorë të njësive administrative për të parë se sa të kënaqur ishin ata me ndarjen e re administrative dhe sa mundësi kishin me organizimin e ri të ofronin shërbime për banorët e njësive të tyre. Në fazën e tretë u kryen ballafaqime të banorëve me zyrtarë vendorë, të zgjedhur dhe të punësuar, për të komunikuar drejtpërdrejt shqetësimet e tyre dhe për t'i dhënë zgjidhje problemeve të komunitetit. Në fazën e katërt, u organizua një takim më të zgjedhur vendorë, administratën dhe përfaqësues të shoqërisë civile



për të komunikuar gjetjet e VQK dhe për t'i adresuar ato në politikat e bashkisë dhe njësive administrative.

Për të parë ecurinë e rekomandimeve të nxjerra në vitin 2014, të cilat shërbyen për hartimin e programeve elektorale për zgjedhjet vendore të vitit 2015, projekti zbatoi të njejtën metodologji vlerësimi edhe në vitin 2017. Vlerësimi aktual mundëson monitorimin e rekomandimeve të qytetarëve të njësive administrative të dhëna në vitin 2014 për qeverisjen e re të mandatit 2015-2019, se sa janë duke u zbatuar prej bashkisë dhe njësive administrative të saj. Vlerësimi aktual bën edhe një krahasim të rekomandimeve për vitin 2015, se sa janë adresuar ato gjatë dy viteve të para të mandatit qeverisjes 2015-2017 dhe të rekomandimeve për dy vitet e ardhshme të mbetura prej mandatit aktual 2018-2019. Rezultatet vlejné për llogaridhënien e autoritetit vendor ndaj qytetarëve dhe për rritjen e përgjegjshmërisë publike të të zgjedhurve vendore ndaj politikave të mirëqenies publike.

Procesi i vlerësimit u përmbush përmes një pyetsori të njejtë për të siguruar njëtrajtshmëri dhe mundësi krahasimi të opinioneve të qytetarëve dhe të zyrtarëve vendore. Vlerësimi u krye përmes skedave të vlerësimit, fokus grupeve dhe ballafaqimeve.

#### *Skedat e vlerësimit*

Çështjet që u shtruan për diskutim ishin të njejtë në të gjitha takimet si në fokus grupet ashtu edhe në debatet ballafaqese, me qëllim që të ruhej e njejtë linjë debati për vlerësimin e nevojave dhe shërbimeve. Për drejtimin e diskutimit në fokus grupe dhe në debate ballafaqese u caktua një listë paraprake çështjesh që u huazua nga metodologjia standarte e vlerësimit me pikë (Community Based Score Cards– CBSC) e përdorur në vende të ndryshme për të matur nivelin e kënaqësisë së komunitetit me shërbimet publike. Vlerësimi përfshinte 5 shkallë që variojnë nga 1-5, ku 1 shënonte shkallën më të ulët të kënaqësisë dhe 5 shkallën më të lartë (në shtojcën A. është paraqitur një model skede pikëzimi). Treguesit për vlerësimin e komunitetit për qeverisjen vendore (VKQ) ishin 20 dhe u grupuan katër seksione:

- (i) Aksesi cilësia e shërbimeve publike pas reformes territoriale;
- (ii) demokracia vendore dhe mirëqeverisja,
- (iii) zhvillimi ekonomik vendor;
- (iv) të drejtat e grave

Në lidhje me shërbimet publike, treguesit kanë të bëjnë me aksesin e banorëve në shërbimet publike dhe me cilësinë e shërbimeve të bashkisë dhe njësive administrative para dhe pas reformës administrative, domethënë para dhe pas viti 2015, me vënien në jetë të ndarjes së re territoriale sipas të cilës komunat dhe bashkikitë e vogla iu bashkangjitën si njësi administrative bashkisë Vlorë. Qëllimi ishte të kuptojhëj nëse rritja e bashkisë, më futjen e njësive vendore të mëparshme brenda hartës së re, kishtë përmirësuar apo përkeqësuar aksesin tek shërbimet dhe cilësinë e tyre dhe se sa ishin banorët në gjendje të gjenin zgjidhje për problemet e tyre në njësitë vendore pas konfigurimit të ri territorial dhe organizativ të qeverisjes vendore.

Në lidhje më demokracinë vendore dhe mirëqeverisjen u vlerësuan treguesit: pjesëmarrja në vendimmarrjen publike me fokus barazinë gjinore dhe angazhimi politik i vajzave dhe grave si të zgjedhura vendore dhe si figura politike në kohë zgjedhjesh (komisionere, fushatuese, aktiviste, etj).

Për zhvillimin ekonomik vendor u vlerësuan treguesit: shërbimet mbështetëse (çerdhe/kopshte) për punësimin e nënave të reja, mbështetja ekonomike e grave në nevojë; formimi profesional për gratë dhe vajzat punëkërkuese; iniciativa mbështetëse në favor të punësimit të grave (nxitja e punësimit dhe e biznesit të grave); situata ekonomike e njësisë; politika e manazhimit të tokës.

Cilësia për shërbimet publike u vlerësua me këta tregues performance: rrugët, transporti, uji i pijshëm, kanalet kulluese/ vaditëse, ndriçimi, parqet shlodhëse dhe pastrimi. Banorët u pyëten se sa akses kanë ata tek shërbimet e bashkisë dhe sa të kënaqur janë ata me cilësinë e rrugëve, gjelberimit, pastrimit, ujit, dhe menaxhimit të hapësirës publike në funksion të interesave dhe mirëqenies së banorëve.

Në lidhje me dhunën me bazë gjinore, treguesit e performancës ishin: prania e shërbimeve në nivel vendor për adresimin e dhunës ndaj grave (struktura në nivel vendor, shërbime, etj). Kjo fushë mbulon të drejtat e njeriut dhe ka të bëjë me nivelin e respektimit të tyre në nivel vendor, sidomos për dukurinë shqetësuese të përhapjes së dhunës ndaj grave në familje.

Gjithashtu për vlerësimin e situatës së vajzave dhe grave në këto njësi vendore, u përdorën edhe dokumentet e politikës sociale dhe kuadri ligjor në fushën e barazisë gjinore duke u fokusuar në 4 fusha: (i) përfaqësimi politik; (ii) gjendja ekonomike; (iii) shërbimet publike dhe (iv) dhuna me bazë gjinore. Për

secilën fushë u përcaktuan pyetje më të specifikuara në mënyrë që të lehtësohej procesi i diskutimit dhe të mblidhej informacion për gjendjen e vazave dhe grave në këto katër aspekte.

### **2.1. Fokus grupet**

Vlerësimi i nevojave të komunitetit për shërbime publike dhe përgjigja e pushtetit vendor ndaj këtyre nevojave u krye përmes fokus grupeve: 4 me komunitetin dhe 4 me pushtetin vendor. Në përfundim të fokus grupeve u organizuan edhe 4 debate ballafaqimi mes komunitetit dhe pushtetit vendor për të evidentuar problemet dhe për të gjetur zgjidhje institucionale.

Si fillim projekti organizoi takime me përfaqësues të komunitetit në të 4 njësitë administrative: Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Në secilën njësi vendore, qendra Aulona organizoi fokus grupe me përfaqësues të komunitetit, banorë të këtyre zonave. Fokus grupet me komunitetin u kryen pa praninë e përfaqësuesve të qeverisjes vendore në mënyrë që banorët të shpreheshin lirshëm për problemet dhe të diskutonin mes tyre se cilat ishin nevojat më imediate për komunitetin në përgjithësi dhe për gratë në veçanti. Fokus grupet nxitën dialogun qytetar dhe krijuan mundësi për rrahje opinionesh dhe argumentim problemesh me fakte nga jeta e përditshme në komunitet. Në çdo takim, pjesëmarrësve iu shpjegua metodologjia e vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen Vendore (VKQ) dhe sistemi i pikëve (CBSC). Pjesëmarrësit në takime përfaqësonin komunitetet përkatëse.

Aktiviteti i dytë i ndërmarrë për vlerësimin e punës së qeverisjes vendore për komunitetin u krye me punonjës të njësive administrative: Orikum, Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Në këto takime morën pjesë zyrtarë të zgjedhur dhe punonjës të administratës vendore. Në fokus grupet me pushtetin vendor u diskutua mbi cilësinë e shërbimeve që njësitë vendore ofrojnë për banorët e tyre pas ndarjes territoriale dhe bashkerendimi me administratën e Bashkisë Vlorë. Takimet u realizuan përmes një reflektimi vetëvlersues për punën e bërë nga qeverija vendore dhe nxorrën në pah një sërë problemesh që has pushteti vendor në realizimin e detyrave funksionale në dobi të mirëqenies së komunitetit. Çështjet për të cilat u bë vlerësimi ishin identike si ato që u diskutuan nëpër takimet me komunitetin, në mënyrë që të merrej informacion për çështje të njejta si nga komuniteti, në rolin e përfituesit të shërbimeve ashtu edhe nga pushteti vendor në rolin e ofruesit të shërbimeve publike.

## **2.2. Debatet ballafaqese**

Për të plotësuar tablonë e vlerësimit të qeverisjes vendore nga ana e komunitetit dhe nga ana e vetë zyrtarëve të qeverisjes vendore, në përfundim të fokus grupeve me komunitetin dhe pushtetin vendor, u organizuan edhe 4 takime ballafaqese, për t'u dhënë mundësi banorëve, administratës dhe të zgjedhurve vendorë të diskutonin për politikën vendore dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre. Pjesëmarrësit krahasuan vlerësimet me pikë dhe ofruan rekomandime për pushtetin vendor.

## **2.3. Shfletimi i dokumentacionit zyrtar**

Në funksion të projektit u përdor edhe dokumentacioni zyrtar i politikës sociale dhe legjislacionit në fushëçn e çështjeve gjinore. Analiza e dokumentacionit u përdor për të kuptuar përmbajtjen dhe qëllimin e politikave publike në lidhje me barazinë gjinore. Tekstet e analizuar janë dokumentet ligjore dhe politike të prodhuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ku u përzgjedhën:

- Ligji "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare" nr 9669, datë 18.12.2006;
- Ligji "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" nr.9970, datë 24.08.2007;
- Ligji "Për mbrojtjen kundër diskriminimit" nr.10221, datë 04.02.2010;
- Ligji "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" nr. 9355, datë 10.03.2005;
- Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2015-2020;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2015-2020)
- Strategjisë së Punësimit dhe Aftësisimit 2014-2020;
- Plan i Kombëtar të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014-2020;
- Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2014-2020).
- INSTAT raporte/te dhena per popullsine dhe punesimin.

Në Ligjet dhe Strategjitë Kombëtare për Barazinë Gjinore shprehet qartazi vullneti politik për të ndryshuar situatën e pafavorshme të grave në favor të tyre, pasi prej këtij ndryshimi përfitojnë jo vetëm gratë por e gjithë shoqëria. Gjithashtu në dokumentacionin ligjor parashikohen masa për nxitjen e barazisë gjinore në fushat ku njëra gjini nënpërfaqësohet dhe për ta konkretizuar këtë ndërhyrje, ligji parashikon edhe një kuotë përfaqësuese prej 30% në të gjitha postet drejtuese dhe ekzekutive publike si arsimit, punësimi dhe vendimmarja politike. Ndërsa përsa i përket vënies në jetë të kuadrit ligjor për barazinë gjinore në shoqëri, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plan i Veprimit 2015-2020 parashtron një ndërhyrje në katër qëllime të shoqëruara edhe me plan-veprim si më poshtë:

Qëllimi Strategjik 1: Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave.

Objektivi 1.1: Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe reduktimi i hendekut gjinor;

Objektivi 1.2: Reduktimi i punës së papaguar të grave në familje duke rritur aksesin dhe cilësinë tek shërbimet sociale;

Objektivi 1.3: Fuqizimi ekonomik i grave në zonat rurale;

Objektivi 1.4: Reduktimi i varfërisë së grave dhe vajzave;

Qëllimi strategjik 2: Garantimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit faktik dhe të barabartë të grave në vendim-marrjen politike e publike.

Objektivi 2.1: Rritja e vendim-marrjes në proceset publike të grave në nivel drejtues dhe proceset ligjvënëse, politikëbërëse dhe planifikuese në nivel qendror

Objektivi 2.2: Rritja në 40% e përfaqësimit të grave në proceset publike në nivel drejtues të politikëbërjes dhe planifikuese në nivel vendor

Qëllimi Strategjik 3: Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Objektivi 3.1: Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Qëllimi strategjik 4: Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore.

Objektivi 4.1: Përmirësimi i Sektorit të Barazisë Gjinore, në përputhje me rolin e tij sipas legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të konventave e dokumenteve ndërkombëtare

Objektivi 4.2: Konsolidimi i rrjetit të Nëpunësve Gjinorë në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, si dhe garantimi i qëndrueshmërisë së tyre.

Objektivi 4.3: Aplikimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe i planifikimit të ndjeshëm gjinor në të gjitha nivelet, në politikëbërje e vendim-marrje.

Objektivi 4.4. Ndërgjegjësimi i shoqërisë për pranimin e barazisë gjinore si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit.

Këto dokumente ligjore e politike u përdorën për të hartuar çështjet e diskutimit publik të debatuarra nëpër fokus grupe dhe debate ballafaqese. Gjithashtu ato u përdorën edhe për të parë nëse objektivat

strategjike të politikave të zhvillimit në fusha të ndryshme dhe sidomos ato të lidhura me barazinë gjinore janë duke u përmbushur nga njësitë e qeverisë vendore.

**2.4. Lista e aktiviteteve të realizuara nga Qendra Aulona për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen Vendore- Score Cards 2017**

<b>Nr</b>	<b>Emri i aktivitetit</b>	<b>Data</b>	<b>Vendi</b>	<b>Nr.pjesemarres</b>
1	Fokus grup me komunitetin Shushice	23 tetor 2017	Shushice	24
2	Fokus grup me pushtetin vendor për vetëvlerësimin Shushice	18 tetor 2017	Shushice	9
3	<b>Debat i Hapur pushtet vendor- komunitet Shushice</b>	25 tetor 2017	Shushice	36
4	Fokus grup me komunitetin Novosele	26 tetor 2017	Novosele	18
5	Fokus grup me pushtetin vendor për vetëvlerësimin Novosole	17 tetor 2017	Novosele	11
6	<b>Debat i Hapur pushtet vendor- komunitet Novosole</b>	27 tetor 2017	Novosele	23
7	Fokus grup me komunitetin Qender	4 tetor 2017	Qender	22
8	Fokus grup me pushtetin vendor për vetëvlerësimin Qender	3 tetor 2017	Qender	11
9	<b>Debati Hapur pushtet vendor- komunitet Qender</b>	6 Tetor 2017	Qender	30
10	Fokus grup me komunitetin Oriku	20 Tetor 2017	Oriku	27
11	Fokus grup me pushtetin vendor për vetëvlerësimin Oriku	3 nentor 2017	Oriku	9
12	<b>Debat i Hapur pushtet vendor- komunitet Oriku</b>	8 Nentor 2017	Oriku	35
<b>TOT</b>	4 NJA, 8 Fokus grupe, 4 Ballafaqime	Tetor-Nentor	Oriku, Novosele Qender Shushicë	255

### III. REZULTATET E VLERËSIMIT

#### 1. Shërbimet publike: aksesit dhe cilësia

Shërbimet infrastrukturore kanë ndikim tek shërbimet sociale për banorët, shërbimi shëndetësor dhe cilësia e jetës si në arsimimin e fëmijëve. Seksioni i pyetjeve për shërbimet u nda në dy nënseksione:

1. aksesit dhe tipologjia
2. cilësia dhe efienca

Seksioni i parë adreson nivelin e kënaqësisë së banorëve dhe zyrtarëve vendore për aksesin tek shërbimet e bashkisë së re dhe tipologjinë e shërbimeve që ofrohen prej bashkisë së re Vlorë në njësitë administrative Shushicë, Orikum, Novoselë dhe Qendër. Qëlimi është të dihet nëse gama e shërbimeve është reduktuar apo është shtuar me hartën e re dhe funksionet e centralizuara në nivel bashkie Vlorë. Ndërsa, seksioni i dytë trajton cilësinë dhe eficienten e shërbimeve të ofruara nga bashkia e madhe dhe delegimin e tyre tek njësitë administrative. Në këtë seksion, vlerësohet cilësia dhe efienca e shërbimeve që aktualisht ofrohen në njësitë administrative.

#### **1.1. Aksesit dhe tipologjia e shërbimeve publike**

Meqë një nga shqetësimet për banorët është nëse reforma administrative-territoriale do të prekë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve publike që deri dje jepeshin nga komunat, seksioni i parë i pyetjeve për shërbimet adreson pikërisht këtë shqetësim: sa arrin bashkia e Vlorës t'u sigurojë shërbime publike cilësore banorëve të ish-bashkisë Orikum dhe ish-komunave Shushicë, Novoselë dhe Qendër? Kjo pyetje iu drejtua të tre grupeve të përfshira në kërkim: banorëve, punonjësit të administratës vendore dhe të zgjedhurve vendorë.

Banorët e Shushicës vlerësojnë se reforma administrative territoriale nuk e ka prekur aksesin e tyre tek shërbimet publike. Ata nuk shohin ndonjë diferencë mes ofrimit të shërbimeve nga ana e ish-komunës Shushicë deri në vitin 2015 dhe nga ana e bashkisë së madhe Vlorë, pas vitit 2015. Aksesit tek shërbimet është i njëjtë dhe cilësia është shumë e mirë. Për përfaqësuesit e njësisë vendore ka edhe rritje të shërbimeve, si për shembull përgatitja e dosjeve për përfitimin e certifikatës së pronësisë dhe pajisjen me AMTP. Gjithashtu, zyrtarët shprehen se reforma administrative-territoriale ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e shërbimeve vendor, pasi ka shtuar mundësinë për investime infra-strukturore. Me parë nuk kishin të ardhura që të mund të investonin për infrastrukturën, kurse tani janë bërë investime të mëdha si: në infrastrukturën rrugore, godina e Njësisë Administrative, Qendra Shëndetsore, rruga e

Risilisë dhe rruga e Llakatundit. Gjithesesi, banorët janë më të kënaqur se zyrtarët vendorë për shërbimet që ofrohen në Shushicë prej bashkisë Vlorë (për detaje mbi pikëzimin referojuni tabelës përmbledhëse për aksesin). Përgjithësisht, banorët e Shushicës e vlerësojnë më pozitivisht aksesin tek shërbimet se sa zyrtarët. Ndërsa zyrtarët shprehen më optimistë për shtimin e tipologjisë/gamën e shërbimeve publike dhe adresimin më të shpejtë të nevojave.

Vleresimi i banorëve dhe i zyrtarëve për aksesin tek shërbimet publike në Orikum është i njejtë. Ata shprehen se shërbimet janë njësoj edhe për nga cilësia, edhe ofruesit e shërbimeve janë të njejtët, pra nuk kanë ndryshuar. Gjithësesi, mungon shërbimi juridik në njësi, gjë që konsiderohet si nevojë. Gjithashtu, shërbimet për mirëmbajtjen, parqet, këndet e lojname, etj janë centralizuar në bashkinë e madhe dhe njësi nuk ka më kompetenca vendimmarrëse në lidhje me to. Kjo konsiderohet si një shfuqizim i njësisë vendore për të vendosur për shërbimet në territorin që administron.

Në Novoselë banorët shprehen se aksei tek shërbimet është ngushtuar, pasi është pakësuar numri i shërbimeve si: shërbimi veterinar, mirëmbajtja e rrugëve dhe e varrezave. Të të njejtit mendim janë edhe zyrtarët vendorë të cilët shprehen të pakënaqur për largimin e disa shërbimeve nga njësi. Në Novoselë nuk ka pasur investime nga ana e bashkisë Vlorë. Stafi është shkurtuar dhe bashkë me të edhe numri i shërbimeve që ofroheshin më parë nga Komuna. Novosela, si njësi administrative me një numër të reduktuar stafi (27 punonjës) nuk është në gjendje të mbulojë nevojat e 18.000 banorëve që jetojnë aty dhe në fshtrat përreth. Reforma duket sikur e ka përkeqësuar gjendjen e shërbimeve duke shkaktuar ndikim negative në reduktim stafi dhe shërbimesh. Megjithatë, një shërbim i nevojshëm është shtuar, ai për përgatitjen e dosjes së certifikatës së pronësisë dhe pajisjen me AMTP.

Banorët e Qendrës janë më të kënaqur me aksesin dhe tipologjinë e shërbimeve, pasi për ta asgjë s'ka ndryshuar për keq me zbatimin e reformës, përkundrazi është shtuar shërbimi për pajisjen me certifikatë pronësie për tokën bujqësore. Banorët shprehen shumë të kënaqur me aksesin tek shërbimet. Zyrtarët janë më pak optimistë se sa banorët për aksesin dhe tipologjinë e shërbimeve të bnjesisë pas reformës.

**Tabela e pikëzimit për aksesin tek shërbimet publike**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>4</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>3</b>	<b>3</b>



<b>3</b>	Novoselë	<b>3</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>5</b>	<b>3</b>
	Mesatare	<b>3.75</b>	<b>2.75</b>

Si përfundim, vlerësimi i banorëve është përgjithësisht më pozitiv se sa ai i zyrtarëve për aksesin tek shërbimet publike dhe për tipologjinë e shërbimeve të ofruara prej njësisë pas reformës territoriale administrative. Për banorët, përvec atyre të Novoselës, shërbimet janë pothuajse të njëjtat, ndërsa për zyrtarët ka një rrudhje të shërbimeve dhe stafit, gjë që ndikon negativisht në mundësinë e njësive për të ofruar shërbime cilësore dhe në kohë, sipas nevojave të komunitetit. Më të kënaqurit janë banorët e Qendrës dhe Shushicës. Ndër zyrtarët, nivelin më të ulët të kënaqësisë për shërbimet e shfaqin ata të Novoselës. Vlerësimi i banorëve për aksesin tek shërbimet është një pikë më shumë se sa ai i zyrtarëve.

### **1.2. Cilësia dhe eficaenca e shërbimeve publike**

Për të vlerësuar punën e qeverisjes vendore për shërbimet publike infrastrukturore dhe ato me natyrë social-argetuese (parqe, qendra rinore, komunitare, etj) u morën në konsideratë disa tregues të dukshëm, sic janë: furnizimi me ujë të pijshëm dhe cilësia e ujit, prania e parqeve shlodhëse dhe e hapësirave të blerta për banorët, mbledhja dhe trajtimi i plehrave, mirëmbajtja e sistemit kullues dhe lumenjve, infrastruktura rrugore, ndricimi i hapësirave publike, prania e këndeve të lojave për fëmijë dhe qendrave social-kulturore.

Për komunitetin e Shushicës, cilësia e shërbimeve të ofruara në nivel njësie dhe bashkie është njësoj si ajo e para vitit 2015, pra përpara reformës. Punonjësit e njësive administrative Shushicë vazhdojnë të punojnë me të njëjtin përkushtim si edhe më parë dhe mirëpresin të gjithë banorët.

Banorët e Orikutit shprehin pakënaqësi për cilësinë e shërbimeve dhe eficaencën e administratës vendore të njësive, duke evidentuar sorrollatjen e panevojshme nga ana e njësive. Mirëpo stafi i njësive shprehet se banorët kërkojnë shërbime që nuk janë në kompetencë të njësive dhe mërzitën kur nuk shërbehen. Zyrtarët pohojnë se mundohen të jenë eficientë në ofrimin e shërbimeve për cka bie brenda kompetencave të njësive. Zyrtarët mendojnë më pozitivisht për eficaencën e shërbimeve se sa banorët e Orikutit.

Në Novoselë banorët shprehen të pakënaqur me cilësinë e shërbimeve. Ata pohojnë se njësia është e paorganizuar dhe e paaftë të ofrojë shërbime. Zyrtarët mbrohen duke thënë se njësia nuk ka marrë fare

investime dhe problemet vazhdojnë të mos zgjidhen. Novosela ka probleme serioze me furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet. Cilësia e ujit të pijshëm është e keqe për shkak të përzierjes me ujrë e zeza, prandaj është e nevojshme të bëhen investime në ujësjellës kanalizime. Të dyja palët shprehen të pakënaqura për cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të njësive. Komuniteti ka pakënaqësi në lidhje me mungesën e investimeve për shtrimin e rrugëve lidhëse të fshatrave të zonës. Ndërsa zyrtarët e njësive dhe stafi shprehen se cilësia e shërbimeve ka rënë sepse kompetencat që dikur gëzonte komuna janë centralizuar në nivel bashkie dhe bashkia e ka lënë pas dore nevojat e njësive. Gjithashtu, zyrtarët lokalë evidentojnë problemem të bashkërendimit të kompetencave me dikasteret qendrore si psh manaxhimi tokës që duhet të administrohet nga Ministria e Drejtësisë dhe hipoteka. Këto problem janë vecanërisht të mprehta në fshatrat Bishan dhe Aliban. Reforma administrative e ka përkeqësuar cilësinë e shërbimeve dhe ka ulur efikasitetin e shërbimit nga ana e stafit të njësive për shkak të centralizimit të kompetencave nga bashkia Vlorë dhe mungesës së investimeve në njësi.

Banorët dhe zyrtarët e njësive administrative Qendër janë më të kënaqur nga reforma. Sipas tyre cilësia e shërbimeve është përmirësuar pas vitit 2014. Të njëjtin mendim ndajnë edhe zyrtarët, pavarësisht nga tkurrja e kompetencave të mëparshme.

**Tabela e pikëzimit për cilësinë e shërbimeve publike**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	4	3
2	Orikum	3	4
3	Novoselë	2	1
4	Qendër	5	4
	Mesatare	3.5	3

Sikurse për aksesin tek shërbimet, edhe për cilësinë e tyre, banorët janë disi më të kënaqur se sa zyrtarët publikë. Përveç banorëve të Novoselës, banorët e njësive të tjera e kanë vlerësuar si relativisht të mirë dhe shumë të mirë cilësinë e shërbimeve dhe efikasitetin e administratës vendore. Ndërsa zyrtarët janë shprehur më të rezervuar në lidhje me cilësinë pasi një pjesë e kompetencave lidhur me shërbimet janë marrë nga bashkia e madhe dhe nuk ka pasur investime të mjaftueshme sidomos për ujë të pijshëm, kanalizimet dhe rrugët ndër-fshatëse.

### **1.3. Cilësia e ujit të pijshëm**

Pavarësisht se për shërbimet në përgjithësi vlerësimi i komunitetit është relativisht i mirë, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për cilësinë e ujit vlerësimi është jo shumë i mirë. Banorët e Shushicës shprehen

se cilësia e ujit të pijshëm është e keqe dhe uji nuk është i përdorshëm. Banorët janë të pakënaqur edhe me furnizimin e pakët me ujë, ndërkohë që paguajnë rregullisht taksat. Ka zona që nuk furnizohen me ujë dhe të tjera që furnizohen vetëm një herë në ditë për pak kohë. Në fshatrat Bunavi, Llakatund dhe Beshisht nuk ka furnizim me ujë dhe fshatarët kanë hapur puse uji. Edhe zyrtarët vendorë shprehen të pakënaqur me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve, pasi uji nuk sigurohet për disa fshatra, ndërsa aty ku ka furnizim ose është i pamjaftueshëm ose uji vjen i ndotur.

Në Orikum qytet, banorët janë të kënaqur me cilësinë e ujit të pijshëm, ndërsa në fshatrat përreth janë të pakënaqur sepse nuk ka furnizim si psh në Tragjas dhe Dukat fushë ku rrjeti është i amortizuar dhe uji humbet nëpër tubacion, ndërsa në Dukat të Ri uji vjen i ndotur në cesma. Banorët e Orikumit e kanë zgjidhur problemin e pasjes së ujit pa kufizim duke instaluar depozita personale të cilat mbushen gjatë orarit të furnizimit nga ujësjellësi. Zyrtarët janë më optimistë se banorët e fshatrave. Ata pohojnë se rrjeti i ujësjellës-kanalizimeve po përmirësohet përmes një projekti që ka hyrë në fazën e dytë të zbatimit. Investimet do përmirësojnë furnizimin dhe cilësinë e ujit të pijshëm në Orikum dhe fshatrat e njësisë.

Në Novosele, banorët janë shumë të pakënaqur me cilësinë e ujit dhe pohojnë se rrjeti i furnizimit me uje te pijshem eshte tejet i amortizuar. Në disa fshatra uji vjen i perzier me ujerat e zeza ne rubinetin e cesmes. Në tre fshatra nuk ka furnizim me uje: Dellenje, Poro dhe Delisuf. Gjithësesi është bere nje rikonstrukcion i pjesshem, por situata eshte ende shume problematike. Mungesa e ujit të pijshëm ka shkaktuar shumë pakënaqësi tek banorët e Novoselës. Edhe zyrtarët shprehin të njëjtin shqetësim për amortizimin e rrjetit të ujësjellsit dhe ndotjen e ujrave të bardha me ujrata e zeza.

Të njëjtat problem evidentojnë edhe banorët e njësisë administrative Qendër, për të cilët cilësia e ujit të pijshëm është shqetësuese. Rrjeti i ujësjellës-kanalizimeve është i amortizuar dhe ndikon në furnizimin e pakët me ujë. Në fshatra situata është edhe më shqetësuese, pasi nuk ka furnizim si psh në Babicë të vogël dhe në Bestrovë. Në fshatrat e tjerë uji përmban ndryshk dhe është i papërdorshëm. Banorët e Qendrës janë shumë të pakënaqur me cilësinë e ujit të pijshëm. Zyrtarët lokalë janë më optimist përse i përket gjendjes së furnizimit me ujë. Ata pohuan se aktualisht rrjeti është i amortizuar, por bashkia Vlorë ka ndërmarrë disa projekte për përmirësimin e rrjetit dhe për ujësjellsat e Kanines, Panajase, Kerkoves dhe Bestroves.

**Tabela e pikëzimit për cilësinë e ujit të pijshëm**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	2	3
2	Orikum	4 qytet/2 fshat	2
3	Novoselë	1	3
4	Qendër	1	3
	Mesatare	1.75	2.75

Në përfundim, cilësia e ujit sipas banorëve të njësive vendore le shumë për të dëshiruar, përveçse në qytetin e Orikut. Banorët e kanë vlerësuar negativisht pushtetin vendor për këtë shërbim dhe kanë pakënaqësi për mosfurnizimin me ujë dhe cilësinë e keqe të ujit të pijshëm. Zyrtarët vendorë janë më pozitivë në vlerësim pasi mendojnë që investimet e nisura në disa ujesjellësa nga Bashkia Vlorë, do të sjellin përmirësime të rrjetit dhe të furnizimit me ujë të pijshëm.

Nga vlerësimi i mëparshëm në 2014 rezulton se në të trija njësitë vendore, Orikum, Novoselë dhe Qendër aksesit dhe cilësia e ujit të pijshëm ishin problematike. Gjithësesi, në Orikum ka përmirësime në furnizim dhe cilësinë e ujit të pijshëm si pasojë e investimeve të ujësjetllës kanalizimeve. Në Novoselë furnizimi me ujë dhe cilësia e ujit të pijshëm vazhdojnë të jenë shumë problematike. Në çezma rrjedh ujë i ndotur si pasojë e amortizimit të skajshëm të rrjetit të shpërndarjes i cili, përveç problemit të mosmirëmbajtjes, vuan edhe nga shpimet e paligjshme të përdoruesve privatë që e përdorin për lavazhe dhe vaditje. Në lagjet e disa fshatrave nuk ka furnizim me ujë. Njësia Qendër vazhdon të ketë probleme të furnizimit me ujë në Babicë të vogël dhe Bestrovë. Gjithashtu, edhe fshatrat e tjerë ankohen për cilësinë e ujit të pijshëm për shkak të amortizimit të rrjetit shpërndarës. Shushica vuan problem të ngjashme me njësitë e tjera si furnizim i pamjaftueshëm dhe ujë të ndotur. Në përfundim, nga vlerësimi i banorëve gjendja duket se nuk është përmirësuar sa duhet. Mungesa e ujit dhe cilësia e tij janë problem shqetësues për komunitetin njësoj si edhe në 2014. Ndërsa zyrtarët, pavarësisht se e pranojnë ekzistencën e problemit shprehen me nota më pozitive duke shpresuar se investimet në ujësjetllësa të ndërmarra pas 2015 nga bashkia Vlorë do sjellin përmirësime në furnizim dhe cilësi.

#### **1.4. Parqet shlodhëse dhe mjedise argëtuese**

Vlerësimi për parqet shlodhëse dhe hapësirat e blerta është negativ nga të dyja palët, si nga komuniteti ashtu edhe nga zyrtarët vendorë, pasi ato mungojnë krejtësisht. Për këtë shërbim nuk janë bërë fare investime as nga njësitet as nga bashkia. Megjithatë mjedisi rural nuk vuan për gjelbërim, banorët dhe zyrtarët shprehen se nuk ka mjedise shlodhëse për banorët dhe kënde lojrash për fëmijët. Në Shushicë banorët dhe zyrtarët shprehen se nuk ka pasur investime për mjedise argëtuese të hapura dhe as kënd

lojrash. Në Orikum banorët dhe zyrtarët pohojnë se ka lulishte por këndi i lojrave nuk ekziston edhe pse ka një shesh për këtë qëllim. Orikumi ka edhe një mjedis të mbyllur, një dhomë, që shërben si qendër argëtuese për shoqërimin e të moshuarve por që nuk ka kushtet e përshtatshme për t'u përdorur pasi nuk ka investime nga njësia, e cila përvec kushteve fizike duhet edhe të furnizojë qendrën me mjete të dobishme për argëtim si shah, domino, letra etj. Megjithëse ka disa hapësira të gjelbra mes lagjesh, Orikumi nuk ka një park shlodhës si qytet. Hapësirat e gjelbëruara mirëmbahen nga banorët dhe jo nga njësia. Zyrtarët vendorë pohojnë se nga viti 2014 nuk ka pasur investime në këtë drejtim, megjithëse njësia ka propozuar një projekt në bashkinë e Vlorës për krijim e një parku shlodhës dhe për investime për këndin e lojave para sheshit të njësisë, i cili nuk është miratuar ende nga bashkia. Në Novoselë si banorët edhe zyrtarët shprehin se mungesa e një këndi lojnash për fëmijë dhe e një parku shlodhës është problem, sepse familjet nuk kanë mjedise argëtuese publike. Njësia ka hartuar një projekt për ngritjen e një qendre komunitare në shërbim të të gjitha moshave por që nuk është miratuar nga bashkia. Zyrtarët mendojnë që pallati i kulturës së Novoselës mund të përdoret për aktivitete kulturore dhe artistike për të gjallëruar jetën e banorëve. Për ta, problemi qëndron tek mungesa e investimeve nga ana e bashkisë. Në Qendër mungojnë mjediset shlodhese dhe argëtuese për shkak se nuk ka investime në këtë drejtim.

**Tabela e pikëzimit për parqet shlodhëse**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>1</b>	<b>2</b>
	Mesatare	<b>1</b>	<b>1.2</b>

Si përfundim, vlerësimi për gjendjen e parqeve shlodhëse, hapësirave argëtuese të sistemuara dhe e mjediseve për lojna dhe socializim është krejtësisht negativ. Megjithëse njësitë kanë bërë projekte për parqe, kënde lojnash, qendra komunitare, projektet nuk janë miratuar nga bashkia e për pasojë nuk ka pasur investim në këtë drejtim. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, gjendja është pothuajse e njejtë për shkak të mungesës së investimeve. Shumica e iniciativave në lidhje me gjelbërimin midis lagjeve dhe mjedise argëtuese për të vegjlit ndërmerren nga banorët ose biznesi privat, ndërsa njësitë nuk kanë punuar në këtë drejtim. Gjendja paraqitet me mungesa të parqeve, mjediseve të blerta, qendrave publike dhe këndeve të lojave për frekuentim nga banorët.

### **1.5. Cilësia dhe shpeshësia e mbledhjes së plehrave**

Vlerësimi për manaxhimin e mbetjeve është më pozitiv se sa ai për cilësinë e ujit. Në Shushicë banorët e vlerësojnë si të mirë shërbimin e mbledhjes së plehrave. Gjithashtu ata theksojnë se për mbajtjen e mjedisit të pastër ka rol edhe vetë bashkësia. Njerëzit janë të ndërgjegjësuar për mirëmbajtjen pastër të mjedisit ku banojnë. Edhe zyrtarët e njësisë e vlerësojnë pozitivisht shërbimin e mbledhjes së plehrave. Njësia mbulon 9 fshatra dhe ka bërë tenderin për shërbimin e pastrimit. Në Orikum vlerësimi është relativisht pozitiv, sidomos për qytetin e Orikut dhe Dukatin, ku mbeturinat mblidhen rregullisht. Gjithësesi, problem mbetet djegia e plehrave buzë lumit që ndot ujin dhe ajrin. Gjithashtu në fshatin Tragjas nuk ka vendgrumbullime plehrash. Zyrtarët vendor shprehen pozitivisht dhe pohojnë se në Tragjas do caktohen vendgrumbullimet e plehrave. Në Novosele banorët shprehen më pak të kënaqur se sa zyrtarët vendorë për pastrimin e plehrave. Sipas banorëve, mbeturinat nuk mblidhen në disa fshatra si: Skrofotinë, Cerkovinë dhe Selevac. Grafiku i Njësisë Administrative për pastrimin nuk zbatohet gjithmone. Për zyrtarët, shërbimi i pastrimit është i shkëlqyer. Por duhet më shumë bashkëpunim me banorët për të propozur mbeturinat biologjike në bahcet e tyre. Në njësinë Qender 2/1 vlerësimi i banorëve dhe zyrtarëve për menaxhimin e plehrave është negativ. Për banorët problemi është i trashëguar dhe nuk ka marrë zgjidhje as në këtë mandat. Mbeturinat nuk mblidhen sepse nuk ka vendgrumbullime, sidomos në fshatra. Sipas zyrtarëve tenderi i bashkisë për pastrimin nuk është organizuar ende dhe pastrimi bëhet me kontribut vullnetar nga bizneset e zonës.

**Tabela e pikëzimit për manaxhimin e plehrave**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>4</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>3</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>3</b>	<b>5</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>2</b>	<b>1</b>
	Mesatare	<b>3</b>	<b>3</b>

Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, gjendja e pastrimit të plehrave duket e përmirësuar, përveçse në njësinë Qendër. Plehrat pastrohen rregullisht dhe shërbimi është nënkontraktuar. Gjithësesi, pavarësisht përmirimit, problem ka sidomos në fshatra ku nuk ka vendgrumbullime plehrash dhe ku nuk ka menaxhim mbetjesh. Njësia ka vendosur një grafik për mbledhjen e plehrave. Banorët janë më të ndërgjegjësuar për mbajtjen e mjedisit pastër dhe përdorimin e koshave. Problem ngelet djegja e plehrave ne Orikum, pranë lumit , gjë që shkakton ndotje të ajrit dhe ujit.

### **1.6. Kanalizimet**

Vlerësimi për kanalizimet është i ngjashëm me atë për cilësinë e ujit të pijshëm. As banorët dhe as zyrtarët nuk janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të kanalizimeve, prandaj japin vlerësim negativ. Në Shushicë banorët shprehen se edhe pse janë bërë investime në kanalizime ato nuk mirëmbahen dhe mbushen me mbeturina nga qytetarët dhe lokalet. Për zyrtarët, megjithëse gjendja e kanaleve është përmirësuar nga ana e njësisë, problem mbetet sjellja e banorëve dhe e lokaleve që bllokojnë kanalet me mbeturina. Në Orikum banorët shprehen se nuk janë bërë investime në kanalet ujtitëse. Ndërtimet mbi kanale shkaktojnë bllokim të tyre dhe përmytje të zonave përreth. Zyrtarët shprehen negativisht për kanalizimet sepse nuk punon hidrovori dhe kanali i kodrës është bllokuar nga ndërtimet. Në Novoselë vlerësimi i komunitetit dhe zyrtarëve është negativ, pasi sipas tyre nuk janë bërë investime. Në Qendër ka pakënaqësi për kanalizimet, pasi megjithëse janë hapur disa kanale ato nuk mirëmbahen dhe përroi në Sherishtë kalon i padisiplinuar në kanal përmes fshatit.

**Tabela e pikëzimit për kanalizimet**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>1</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>2</b>	<b>1</b>
	Mesatare	<b>1.7</b>	<b>2</b>

Megjithëse ka pasur investime në sistemin e kullimit të ujrave dhe kanalizimeve, banorët dhe zyrtarët nuk janë të kënaqur me cilësinë e tyre. Ata shprehen se ujrata e lumejve dhe përrenjve derdhen të padisiplinuar edhe përmes zonave të banuara dhe në disa raste kanalet janë bllokuar për shkak të ndërtimeve pa leje mbi to. Gjithësesi sistemi është përmirësuar krahasuar me vlerësimin e bërë në vitin 2014 gjatë të cilit u evidentuan problem të shumta si : përmytjet, ujrata e zeza, papastërtitë e hedhura në lumenj dhe kanale kulluese, brigjet e lumenjve të mbuluara nga plehrat, dhe prani të shtuar insektesh si pasojë e ndotjes.

### **1.7. Cilësia e infrastrukturës rrugore**

Cilësia dhe infrastruktura rrugore nuk kanë marrë vlerësim pozitiv nga komuniteti. Në Shushicë banorët shprehen se infrastruktura rrugore është e keqe, sidomos rrugët e lagjeve. Zyrtarët shprehen më pozitivisht për cilësinë e rrugëve për shkak të investimeve të kryera pas viti 2015. Në Orikum banorët japin vlerësim pozitiv për cilësinë e rrugëve, megjithëse ka nevojë për përmirësime në disa fshatra për rrugët e amortizuara, Tragjas dhe Dukat fshat. Edhe rruga e buzës së detit vazhdon të jetë problem për

Orikum duke penalizuar edhe turizmin. Perfaqesuesit e NjA-se informojnë se rruga në breg do kthehet në shëtitore me fondet e qeverisë. Në Novosele banorët japin vlerësim jo pozitiv për cilësinë e infrastrukturës rrugore, pasi megjithë përmirësimet në Aliban, Akerni dhe Mifol, rrugët janë në gjendje të keqe në Trevllazer, Skrofotine, Cerkovine dhe Bishan. Zyrtarët shprehen se projektet janë gati, por mungojne investimet. Edhe në Qender vlerësimi nuk është pozitiv, pasi rrugët në fshatra janë të parregulluara si në Bestrovë, Kërkovë, Hoshtimë, Babicës së Vogël. Zyrtarë shprehen se ka filluar të zbatohet projekti për rrugën Babice e Vogël- Bestrovë, ndërsa për fshtrat e tjerë nuk ka ende investime.

**Tabela e pikëzimit për rrugët**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	2	3
2	Orikum	4	3
3	Novoselë	2	3
4	Qendër	2	2
	Mesatare	2.5	2.7

Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm, megjithë investimet në disa rrugë (Mifol, Akerni, Aliban), vlerësimi nuk është pozitiv, pasi infrastruktura rrugore në fshatra vazhdon të jetë e keqe. Aktualisht janë duke u kryer punime për rrugën lidhëse Babicë e Vogël-Bestrovë.

### **1.8. Cilësia e ndriçimit në rrugë**

Vlerësimi për ndriçimin është shumë negativ si nga banorët edhe nga zyrtarët vendorë. Në Shushicë banorët dhe zyrtarët shprehen se pavarësisht se mblidhen taksat, rrugët nuk kanë ndriçim (përveç Risilisë). Në Orikum banorët dhe zyrtarët japin një vlerësim relativisht pozitiv për ndriçimin, megjithëse duhet të ketë ndriçim në shëtitore dhe në brendësi të lagjeve. Ndërsa zyrtarët shprehen se duhen investime për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit dhe zëvendësimin e llampave. Në Novosele vlerësimi është negativ, pasi nuk ka mbulim me ndriçim përveçse Novosela dhe Fitoja. Në Qendër vlerësimi është negativ pasi nuk ka ndriçim dhe banorët nuk kanë siguri në rrugë në orët e mbrëmjes. Zyrtarët shprehen se ka problem me ndriçimin, përveçse në Babicë, Nartë, Panaja.

**Tabela e pikëzimit për ndriçimin**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	1	1
2	Orikum	3	3
3	Novoselë	1	1
4	Qendër	1	2
	Mesatare	1.5	1.7



Cilësia e ndricimit në këtë vlerësim është e njëjtë me vlerësimin e mëparshëm, pra jo pozitiv. Përveç Orikumit, në njësitë e tjera ka probleme të trashëguara me ndriçimin, të cilat nuk janë zgjidhur as këto dy vite.

## **2. Demokracia vendore: pjesëmarrja qytetare dhe mirëqeverisja**

Kjo pjesë e raportit lidhet me vlerësimin për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë politik dhe vendimmarrës të grave me burrat. Si tregues të përfaqësimit politik të grave në strukturat vendimmarrëse publike u konsideruan dy faktorë:

- përfaqësimi në këshillat vendore;
- pjesëmarrja në komisionet zgjedhore e vajzave dhe grave të zonës.

Banorët e njësive janë mesatarisht të kënaqur me përfaqësimin gjinor në vendimmarrjen publike. Në Shushicë vlerësimi është nën mesatarin, pasi gratë janë shumë të nënpërfaqësuara edhe në vendimmarrje edhe në administratën e njësisë. Komuniteti ngre shqetësimin se edhe pse ka shume vajza dhe gra që janë të arsimuara, ato vazhdojnë të mos punesohen pranë komunitetit të tyre por, shpesh vijne vajza ose gra nga Vlora të punojnë në fshat dhe sipas tyre kjo nuk është e drejte. Zyrtarët vendorë e vlerësojnë si shumë të mirë përfaqësimin e grave në vendimmarrje karahasuar me mandatin e shkuar. Sipas tyre, njësia përfaqësohet në këshillin e bashkisë Vlorë me dy gra, ndër të cila njëra prej komunitetit egjyptian. Nga 9 kryetarë fshatrash, njëra është grua dhe kjo konsiderohet një tjetër arritje për njësinë. Me pare ka pasur vetem nje grua ne keshillin e komunes Shushice. Pra është rritur perfshirja e grave ne proceset vendimarrëse. Megjithatë përfaqësimi i ulët bën që zëri i grave të mos dëgjohet në mbledhjet e partive politike, këshillave dhe administratë. Më shumë se sa nga partitë politike, gratë mbështeten për përfaqësim të balancuar në vendimarrje prej OJF-ve të grave të cilat ofrojnë trajnime për gratë dhe mundësojnë praninë e tyre në proceset konsultative për buxhetin dhe prioritetet.

Në Orikum, komuniteti është i kënaqur me përfaqësimin gjinor, pasi njësia ka një administratë të balancuar me 50% të punonjësve gra. Edhe zyrtarët shprehen relativisht të kënaqur me nivelin e përfaqësimit të grave, por theksojnë se mund të ishte edhe më i lartë falë aktivizimit të tyre në problemet e njësisë. Pavarësisht përfaqësimit të mirë në administratën e njësisë, gratë nuk

përfaqësohen në këshillin e bashkisë Vlorë, pasi njësia përfaqësohet nga burra. Do të ishte e pëlqyeshme për banorët të kishte edhe një këshilltare grua, pasi gratë janë më aktive në komunitet, pavarësisht se në mbledhjet e partive politike nëpër fshatra, pjesëmarrës janë vetëm burrat. Ndersa ne Orikum grate jane gjithmone pjesemarrrese neper takime. Forumi i pavarur i ngritur nga Qendra Aulona po ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset konsultative për buxhetin.

Në Novoselë gjendja duket mesatarisht mirë për komunitetin dhe shumë e mirë për zyrtarët vendorë. Sipas përfaqësuesve të komunitetit, pjesëmarrja në vendimarrje publike, në NJA Novosele, p.sh. është e kënaqshme, gati 50% e punonjeseve janë gra. Edhe në Këshillin bashkiak, nga dy këshilltare që janë përfaqësues të kësaj njësie, njëra është grua. Por përfaqësuesit e NJA-se kujtojnë se dikur në këshillin e komunes kanë qenë tre gra e vajza, për shkak të komuna kishte këshillin e vet dhe këshilli komunal kishte më shumë anëtarë dhe mundësonte një përfaqësim më të madh të komunitetit në vendimarrjen publike. Pas reformës, njësia nuk ka më këshill të vetin, por përfaqësohet në këshillin bashkiak Vlorë me këshilltarë të njësisë. Edhe prania e dy këshilltarëve në bashki, prej të cilëve njëra grua konsiderohet sukses pasi ka një balancë gjinore.

Në Qender, gjendja është shumë e kënaqshme, pasi edhe banorët edhe zyrtarët kanë dhënë një vlerësim maksimal për përfaqësimin e grave. Krahasuar me mandatin e shkuar, gjendja duket e përmirësuar sidomos në numrin e shtuar të vajzave dhe grave në administratën e njësisë, madje edhe në emërimin e tyre administratore njësie. Por përfaqësimi mund të ishte edhe më i lartë nëse aktivizimi politik do përkthehej në numra, pasi krahasuar me punën fushatuese që gratë bëjnë për partitë politike niveli i përfaqësimit duhej të ishte më përfaqësues. Gjithësesi në periudha midis zgjedhjes, sidomos nëpër fshatra, partitë politike mbledhin nëpër mbledhje kryesisht burra, dhe prania e grave zbehet.

**Tabela e pikëzimit për barazinë gjinore në vendimarrjen publike**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	2	5
2	Orikum	4	3
3	Novoselë	3	5
4	Qendër	5	4
	Mesatare	3.5	4

Përgjithësisht, përfaqësimi politik i grave në strukturat vendimmarëse është përmirësuar në krahasim me mandatin e shkuar. Përveçse në Shushicë, ku vlerësimi i komunitetit për përfaqësim të balancuar gjinor është negativ, në njësitë e tjera komuniteti shprehet më i kënaqur. Edhe zyrtarët vendorë shprehin një nivel të lartë kënaqësie me përfaqësimin gjinor në vendimmarje dhe administratë, duke evidentuar faktin se gratë janë gati 50% e administratës vendore, përfaqësojnë njësitë në këshillin e bashkisë Vlorë dhe janë emëruar administratore në njësi. Gratë kanë aktivizim të lartë në evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Një rol të cmuar në mbështetje të grave ka luajtur shoqëria civile sidoms organizata e gruas AULONA e cila ka ngritur Forumin e Pavarur Qytetar për të angazhuar gratë në proceset konsultative me bashkinë dhe njësitë administrative të Vlorës. Partitë politike tregojnë më shumë interes për angazhimin e grave në fushat zgjedhore, ndërsa në periudha ndër-zgjedhore i përfshijnë pak ose aspak (në fshatra) duke bërë që gratë të mos kenë zë në strukturat partiake.

### **3. Zhvillimi ekonomik vendor dhe pozita e grave**

Ndër faktorët vlerësues për gjendjen ekonomike të vajzave dhe grave në njësitë administrative janë përfshirë disa tregues, si: sistemi i përkujdesit shoqëror për femijët në moshë parashkollore, përfaqësuar me çerdhet dhe kopshtet, ndihma ekonomike për gratë në nevojë dhe të papuna, nxitja e punësimit të grave dhe vajzave, gjendja ekonomike e zonës dhe sa e favorizon ajo punësimin femëror, si dhe shërbimet vendore për formimin profesional të vajzave dhe grave punë-kërkuese.

#### **3.1. Përkujdes social për fëmijët dhe shkollat**

Sistemi i përkujdesit shoqëror për fëmijët në moshë parashkollore lidhet me lehtësimin e nënave nga detyra e përkujdesjes ditore dhe çlirimin e kohës fizike të tyre për t'u punësuar. Përkujdesi publik për fëmijët në moshë parashkollore është parakusht për të mundësuar punësimin e nënave me fëmijë të vegjël. Shërbimi publik për përkujdes për të vegjlit 0-3 vjeç mungon. Nuk ka çerdhe publike dhe nënat e reja që kanë fëmijë në këtë moshë nuk mund të aktivizohen në punë me pagesë pasi përkujdesen për të vegjlit. Gjithashtu, mospunësimi i nënave ndikon edhe në kërkesat e ulëta për shërbimin ditor të çerdheve. Shërbimi publik për përkujdes për moshën 3-6 vjeç paraqitet në gjendje më të mirë se sa çerdhet. Të gjitha zonat kanë mbulim me shërbim kujdestarie ditore me kopshte publike për fëmijët e kësaj grupmoshe. Gjendja materiale e kopshteve është relativisht e mirë falë investimeve që bashkia dhe njësitë kanë bërë në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave 9-vjeçare. Në Shushicë komuniteti është mesatarisht i kënaqur për cilësinë e përkujdesit social të kopshteve, ndërsa zyrtarët vendorë janë më të kënaqur se sa komuniteti. Infrastruktura e shkollave është në gjendje të mirë. Shkolla e

Llakatundit është në kushte të mira dhe në distancë të shkurtër nga vendbanimet e arritshme prej nxënësve me këmbë. Edhe shkolla e Risilisë është në kushte të mira. Megjithë përmirësimet në infrastrukturë shkollave u mungon ngrohja për dimër. Në Orikum komuniteti shprehet më i kënaqur se sa zyrtarët për gjendjen e shkollave dhe kopshteve. Gjithësesi janë evidentuar probleme në infrastrukturën e disa shkollave që kanë nevojë për ndërhyrje si shkolla në Dukat Fushe, te ciles i pikon catia, ose shkolla 9-vjecare "B.Pelari" që duhet restauruar. Perfaqesuesit e administrates informojnë se restaurimi i shkollave është përfshirë në ne buxhetin e 2018. Në Novoselë banorët nuk janë të kënaqur me infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave, ndërsa zyrtarët janë mesatarisht të kënaqur. Banorët shprehin pakënaqësi për mirëmbajtjen e shkollave dhe shërbimin e pastrimit të cilat mbulohe nga prindërit. Shkollat janë pa ngrohje në dimër. Tualetet mungojnë ose janë të papërdorshme si psh në fshatin Bishan, ku fëmijët djem detyrohen të urinojnë në shishe plastike që marrin me vete në shkollë. Sipas zyrtarëve të njësisë, Novosela duhet të ketë një shkollë për të gjitha fshatrat e njësisë për të krijuar klasa sipas moshës dhe jo klasa kolektive. Shkollat nuk kanë mjedise sportive ose i kanë në gjendje të degraduar për shkak të mungesës së investimeve nga pushteti vendor. Për shkollën e Alibanit mendohet të shndërrohet në të mesme profesionale me drejtim bujqesor-blegtoral. Në Qendër banorët janë të pakënaqur me infrastukturën e kopshteve dhe shkollave. Janë kryer rikonstruksione të pjesshme si në Babicë, Panaja dhe Alikokë dhe pritet të tenderohen shërbimet për mirëmbajtjen. Shkollat kanë infrastrukturë të shkatërruar dhe nevojitet rikonstruksion i plotë në Sherishtë, Kërkovë, Oshëtimë. Zyrtarët mendojnë se shkolla e Hoshtimës të mbyllet pasi klasat janë kolektive dhe fëmijët të shkojnë në shkollën e Panajasë.

**Tabela e pikëzimit për përkujdesin social për fëmijët dhe shkollat**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>3</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>2</b>	<b>3</b>
	Mesatare	<b>2.5</b>	<b>3</b>

Në përfundim të vlerësimit për infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave mund të thuhet se banorët janë relativisht të pakënaqur ndërsa zyrtarët, përveç atyre të Orikumit, janë mesatarisht të kënaqur. Kopshtet dhe shkollat kanë problem të infrastrukturës që nga catitë që pikojnë, mungesa e banjove, e ngrohjes dhe mjediseve sportive. Prindërit në disa raste financojnë mirëmbajtjen e shkollës dhe

shërbimin e pastrimit, ndërkohë që ky është shërbim që mbulohet nga pushteti vendor. Krahasuar me vlerësimin e vitit 2014, gjendja e infrastrukturës së kopshteve dhe shkollave paraqitet pak më e përmirësuar. Njësitë administrative kanë projektuar investime në rikonstruksionin e shkollave në buxhetin e vitit 2018.

### **3.2. Ndihma ekonomike për gratë e papuna**

Ndihma ekonomike (NE) kushtëzohet me mungesën e të ardhurave dhe mjetëve të jetësës, mirëpo në zonat rurale toka konsiderohet mjet jetese dhe skualifikon familjet e varfra nga përfitimi. Në rast se plotësohen kushtet, vajzat dhe gratë kanë përparësi, sepse nuk janë pronare dhe për pasojë përfitojnë NE. Në Shushicë, komuniteti shprehet i pakënaqur me NE pasi zona nuk ka zhvillim ekonomik të mirë. Ndër 56 familje në NE, 5 kryesohen nga vajza dhe gra, ndërsa 10 janë familje rome dhe 20 egjiptiane. Zyrtarët shprehen më pozitive për përfitimin e NE nga ana e grave kryefamiljare pasi zbatohen dispozitat ligjore për grupet në nevojë. Në Orikum komuniteti dhe zyrtarët janë të kënaqur me ndihmën ekonomike për gratë e papuna. Orikumi është zonë urbane dhe gratë kryefamiljare që kane burime të kufizuara jetese hyjnë në skemë. Ndër 10 përfituese femra, 2 janë nëna-vajza (dmthënë që prindërojnë të vetme por që janë të pamartuara). Për gratë e varfra nga zonat rurale, pritet që përmirësimet ligjore për NE që do hyjnë në fuqi në 2018 të lehtësojnë pozitën e tyre lidhur me kushtësimin e pronësisë mbi tokën në fshat. Në Novoselë ka diferencë të madhe mes vlerësimit të komunitetit dhe atij të zyrtarëve. Komuniteti ka vlerësim negativ, ndërsa zyrtarët shumë pozitiv për NE për gratë e papuna. Sipas komunitetit mbështetja nuk duhet kushtëzuar me pronësinë mbi tokën në fshat, ndërsa për zyrtarët ligji favorizon gratë kryefamiljare pa të ardhura dhe mjete jetese. Në Qendër komuniteti është më i kënaqur se sa zyrtarët për NE, për gratë në nevojë ekonomike. Të dyja palët mendojnë se ligji e ka adresuar problemin e mbështetjes ekonomike të grave të papauna dhe njësia mbështet me NE 7 familje të kryesuara nga gra dhe numri më i lartë i aplikimeve bëhet nga gratë.

**Tabela e pikëzimit për NE për gratë e papuna**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	2	4
2	Orikum	4	4
3	Novoselë	1	4
4	Qendër	4	3
	Mesatare	2.7	3.7

Vlerësimi i komunitetit për ndihmën ekonomike është më negativ se sa ai izyrtarëve, pasi banorët mendojnë që gratë penalizohen nëse kanë tokë kusht që i skualifikon nga përfitimi i NE. Ndërsa zyrtarët shprehen se ligji e ka këtë kusht por në listën e përfitimit të NE nëse plotësohen kushtet gratë kryefamiljare kanë përparësi në përfitimin e NE. Për gratë e papuna dhe në nevojë ekonomike bashkia dhe komunat nuk ofrojnë ndonjë ndihmë ekonomike, përveçse në rastet kur ato janë kryefamiljare, siç e parashikon edhe ligji për ndihmën ekonomike, sipas të cilit ndihma ekonomike si titull familjar përfitimi i jepet kryefamiljarit të papunë. Pritet që kushti i pronësisë mbi tokën të mos jetë kriter pengues për përfitimin e NE. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, duket sikur mbështetja e grave të papuna me NE është rritur si pasojë e kërkesave ligjore për avantazhimin e grupeve më nevojtare ku kryesojnë gratë.

### **3.3. Nxitja e punësimit**

Nxitja e punësimit ka marrë vlerësim negativ si nga banorët ashru edhe nga zyrtarët vendorë. Banorët e Shushicës vlerësojnë se mënyra më emirë e nxitjes së punësimit është mbështetja nga shteti me fonde e fermerëve për veprimtari bujqësore dhe blegtorale meqë njësia është zonë rurale., si psh subvencionimi i serave dhe magazinimi i produkteve. Investimet në sistemin vaditës dhe kullues do të rrisin prodhimin bujqësor dhe përmirësojnë mundësitë ekonomike të fermerëve. Megjithatë, për gratë është e vështirë të ushtrojnë iniciativën sipërmarrese si fermere për shkak të paragjykimeve partiarkale për rolin e gruas si shtëpiake dhe perkujdesëse më shume se sa si siguruese të ardhurash. Në Orikum dhe Novoselë vlerësimi është krejtësisht negativ, si nga zyrtarët edhe nga banorët që shprehen se nuk ka fare politika të nxitjes së punësimit. Në Novoselë banorët shprehen se shteti duhet të subvencionojë prodhimin dhe të krijë tokën e cila është e papërdorshme për kultura bujqësore. Për zyrtarët zgjidhje mund të jetë ngritja e industrisë fasonë dhe investimet në sistemin vaditës për kulturat bujqësore. Per momentin në zonë ka punë në fabrikat e vajit por nuk ka magazine për mbledhjen e ullirit dhe grumbullimit të produkteve bujqësore. Në Qendër komuniteti shprehet mesatarisht i kënaqur me politikat e nxitjes së punësimit nga bashkia ndërsa zyrtarët e njësisë shprehen se këto politika mungojnë. Komuniteti vlerëson faktin se bashkia financon kurset e formimit profesionale për vajzat dhe gratë e papuna, megjithëse gratë nuk shkojnë për shkak të mentalitetit patriakal. Me kërkesë e Forumit të Pavarur të Grave të NJA Qëndër, Bashkia ka buxhetuar një zë për 2017 për transportin falas për gratë dhe vajzat e zonave rurale që duan të kryejnë kurset profesionale falas në qytet. Kërkesa u përfshi në Kontratën Sociale të firmosur nga kryetari i Bashkisë më 2015, por nuk gjeti zbatim sepse gratë pengohen nga bashkëshortët për arsye të mentalitetit patriakale.

**Tabela e pikëzimit për nxitjen e punësimit për gratë e papuna**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	3	2
2	Orikum	1	1
3	Novoselë	1	1
4	Qendër	3	1
	Mesatare	2.2	1.2

Nxitja e punësimit është një problem i pazgjidhur në nivel vendor pasi qeverisja vendore e ka parë veten të pafuqishme për të bërë gjë në këtë drejtim. Megjithë përpjekjet e njësive dhe bashkisë për nxitjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave të papuna në kurse profesionale të ofruara nga zyrat e punës dhe mbulimit të transportit, këto kurse nuk ndiqen sepse gratë pengohen nga familjarët për shkak të mendësive patriarkale. Krahasuar me vitin 2014, politika e nxitjes së punësimit përmes ofrimit të kurseve profesionale ka njohur zhvillim, por jo zbatim.

### **3.4. Gjendja ekonomike e zonës**

Vlerësimi për zhvillimin ekonomik të zonës është shumë negativ, nga të dyja palët. Zona konsiderohet të ketë nivel të lartë papunësie dhe varfërie. Në Shushicë, familjet i sigurojnë të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore. Në tre fshatra ka prani të komunitetit roma-egjyptian që është shumë i varfër. Gjendja paraqitet thujtë njësoj në Orikum. Pavarësisht migrimit jashtë reinitancat nga emigracioni kanë rënë shumë dhe banorët nuk presin më të ardhura nga emigrantët. Toka është në përdorim dhe jo në pronësi, pasi pronarët janë të tjerë, gjë që zbeh dëshirën e fshtarëve për të investuar. Në disa fshatra toka është e papunueshme ose përmytet se nuk punojnë hrdovorët, por banorët paguajnë taksa sikur ta përdorin. Sipas zyrtarëve vendor gjendja është disi e mirë për shkak të të ardhurave nga emigracioni dhe turizmi. Në Novoselë vlerësimi është shumë negativ. Gjendja ekonomike vlerësohet të jetë shumë e prapambetur, megjithë emigracionin. Banorët shprehen se duan të jetojnë përmes punës dhe për këtë duhen investime në ckripëzim të tokës dhe sistemin e vaditjes me ujë të ëmbël. Familjet pa emigrante kanë një nivel më të lartë varfërie. Zyrtarët vendorë informojnë se ka filluar pastrimi i kanaleve vaditëse për të mundësuar mbjelljen e kulturave bujqësore. Edhe vlerësimi për NJA Qendër është negativ, pasi të ardhurat sigurohen prej shitjes së prodhimeve bujqësore që sigurohen nga familjet.

**Tabela e pikëzimit për gjendjen ekonomike të zonës**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	1	2
2	Orikum	1.5	2.5
3	Novoselë	1	1
4	Qendër	1.5	2.5
	Mesatare	1.2	1.7

Nga vlerësimi I gjendjes ekonomike del se zhvillimi ekonomik nuk ka bërë përparime krahasuar me vitin 2014. Problemet vazhdojnë të jenë të njejta si mungesa e sektorit industrial, e zhvillimit bujqësor dhe e infrastrukturës turistike. Banorët merren me bujqësi dhe blegtori dhe mbijetojnë me të ardhurat prej shitjes së produkteve bujqësore. Të ardhurat nga emigracioni janë vazhdimisht në rënie.

### **3.5. Shërbimet vendore për formimin profesional të vajzave dhe grave punëkërkuese**

Njësitë vendore kanë ndërmarrë disa iniciativa për nxitjen e punësimit femëror në zonë sic janë: mundësimi i pjesëmarrjes në kurse të formimit profesional ofruar nga zyrat e punës dhe financimi i transportit për ndjekjen e kurseve. Në Shushice komuniteti shprehet negativisht për formimin profesional të vajzave dhe grave punëkërkuese, për shkak se ato nuk i përgjigjen iniciativës së bashkisë për të marrë pjesë në kurse formimi. Mendësitë patriarkale janë pengesa kryesore për pjesëmarrjen e grave në kurse formimi profesional. Bashkia ka buxhetuar nje ze per 2017 per te mbuluar transportin falas per grate dhe vajzat e zonaver rurale qe duan te kryejne kurset profesionale falas ne qytet. Ishte nje kerkese e Forumit te Pavarur te Grave te NJA Qender e cila u be pjese edhe e Kontrates Sociale te firmosur nga kryetari i Bashkise me 2015. Nje premtim i bere realitet, por pati veshtiresi per te gjetur disponueshmeri nga ana e grave ne nevojte shpeshhere te penguara nga bashkeshortet per arsye te mentalitetit patriarkal. Nga Shushica 5 gra dhe vajza jane rregjistruar projektin e bashkisë Vlorë për formim profesional falas dhe po ndjekin kurset. Bashkia mbulon edhe transportin për të mundësuar ndjekjen e kurseve.

Fondi i Bashkise per tu ardhur ne ndihme grave dhe vajzave ne veshtiresi ekonomike duke mbuluar transporti falas per kurset falas te formimit profesional menaxhohet nga organizata World Vision. Pra Qendra e Formimit Profesional Vlore ofron kurset dhe bashkia mbulon transportin.

Në Orikum shprehen relativisht të kënaqur me përpjekjet e bashkisë për nxitjen e punësimit të grave përmes formimit profesional falas. Megjithatë pjesëmarrja ne këto kurse është shumë e ulët, vetëm 10 prej tyre e ndjekin.



Në Novoselë shprehen të pakënaqur me pjesëmarrjen e vajzave dhe grave të papuna në kurse profesionale. Si edhe në njësi të tjera, pengesë është mendësia patriarkale që kufizon daljen e grave nga shtëpia dhe aktivizimin profesional dhe ekonomik të tyre. Edhe Novosela është përfshirë në projektin e qe financohet nga Bashkia Vlore dhe menaxhohet nga World Vision, por pjesëmarrja është e ulët. Vetëm 8 vajza dhe gra ndjekin kurse formimi në kulinari dhe rrobaqepsi. Në NJA Qendër vlerësimi komunitar dhe zyrtar është më i kënaqshëm. Përpjekjet e bashkisë për të nxitur formimin profesional me qëllim punësimin e grave punëkërkuese vlerësohet pozitivisht.

**Tabela e pikëzimit për formimin profesional të grave punëkërkuese**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi nga komuniteti	Vlerësimi nga zyrtarët vendorë
1	Shushicë	2	4
2	Orikum	3	4
3	Novoselë	1	2
4	Qendër	3	4
	Mesatare	2.5	3.5

Përgjithësisht vlerësimi aktual evidenton përparime në nxitjen e punëimit të vajzave dhe grave përmes kurseve profesionale, krahasuar me vlerësimin e vitit 2014, ne të cilin theksohet mungesa e programeve mbështetëse për formim profesional.

#### *Pembledhje e zhvillimit ekonomik*

Zhvillimi ekonomik i zonës paraqitet mesatarisht i kënaqshëm. NJA vuajnë nga papunësia si pasojë e mungesës së veprimtarisë prodhuese industriale, veprimtarisë së pakoordinuar bujqësore dhe sektorit të vogël të shërbimeve. Megjithatë, zona ka potencial zhvillimi ekonomik sepse ndodhet buzë detit dhe banorët përfitojnë nga sezoni turistik i verës. Edhe pse e kufizuar në kohë, kjo veprimtari siguron të ardhura mesatare për familjet që e ofrojnë këtë shërbim. Gjithashtu, një pjesë e të ardhurave sigurohen nga remitancat e emigrantëve të cilat edhe pse kanë rënë vazhdojnë të jenë burim për familjet e origjinës. Në disa fshatra gjendja ekonomike është e nivelit mesatar pasi banorët janë pronarë tokash dhe merren më veprimtari prodhuese bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu disa prej tyre kanë krijuar ferma dhe mbarështojnë bagëti, kultivojnë drith, vreshta, e pemë frutore. Gjithashtu, popullsia e zonës kultivon ullinj të cilët i shet edhe si vaj. Pak fshatra paraqesin nje gjendje të dobët ekonomike si: Narta, Zvërneci dhe Panajaja, pasi terreni nuk është i përshtatshëm për mbjelljen e kulturave bujqësore dhe banorët nuk kanë mundësi të investojnë në teknologji moderne të shfrytëzimit të tokës për bujqësi.

Popullsia rurale ka nivel mesatar të ardhurash prej punëve bujqësore, turizmit veror dhe emigracionit. Duke qenë edhe pranë qytetit të Vlorës gjeografikisht, fshtrat kanë mundësi për shitjen e produkteve të tyre bujqësor dhe blegtorale në qytet.

#### **4. Të drejtat e grave: Politikat kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave**

Niveli i dhunës në familje është shqetësues. Për të vlerësuar politikat vendore në lidhje me dhunën në familje u morën në konsideratë dy aspekte të politikës vendore: prania e strukturave për dhunën në familje dhe informimi për dhunën.

##### *4.1. Struktura vendore për dhunën në familje*

Vlerësim i komunitetit i për mbrojtjen e grave nga dhuna është shumë negativ. Komuniteti në Shushicë shprehet se njësitë vendore nuk kanë fare kapacitet mbrojtës, sepse nuk ka as strukture as staf që të mbulojë çështje të dhunës në familje, ndërsa zyrtarët vendorë kanë opinion pozitiv për masat që e marra nga pushteti vendor për adresimin e dhunës, pasi është ngritur një sistem referimi në nivel vendor: administratori social i njësisë shërben edhe si pikë fokale për dhunën në familje dhe e referon rastin tek drejtorja e shërbimit social në bashkinë e madhe tek pika fokale për barazinë gjinore dhe dhunën në familje dhe bashkia e përcjell informacionin për dhunën në polici. Në Orikum vlerësimi është thuajse negativ, pasi edhe banorët edhe zyrtarë të njësisë mendojnë se administratorja e ndihmes ekonomike në bashki nuk është personi i duhur për adresimin e dhunës në familje. Megjithatë ky person duhet të referojë rastin në bashki dhe polici. Në Novoselë vlerësimi është krejtësisht negativ pasi vendi i administratorit social është shkurtuar dhe personi që mbulon çështje të dhunës në familje në njësinë administrative është edhe arkëtar edhe punonjës i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve. Të dyja palët shprehen se për këtë çështje duhet personel në njësi. Në Qendër vlerësimi është negativ, pasi nuk ka struktura për adresimin e çështjeve të dhunës në familje. Personi që merret me ndihmën shoqërore ka për detyrë të mbulojë edhe mbrojtjen nga dhuna.

**Tabela e pikëzimit për dhunën në familje**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>1</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>1</b>	<b>1</b>

<b>4</b>	<b>Qendër</b>	<b>1</b>	<b>2</b>
	<b>Mesatare</b>	<b>1.2</b>	<b>2.5</b>

Për fat të keq asnjëra nga njësitë vendore nuk ka një njësi të trajtimit të rasteve të dhunës në familje. Gjithësesi, punonjëset sociale që punojnë në njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë Njesive Administrative ndihmojnë vullnetarisht gratë e dhunuara duke i drejtuar tek Qendra Vatra që ofron shërbime për gratë e dhunuara. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, vlerësimi aktual evidenton të njejtat probleme për mungesën e strukturave në nivel njësie për adresimin e dhunës në familje.

#### *4.2. Informacion mbi njësitë mbështetëse ku duhet të drejtohen në rast se përjetojnë dhunë*

Vlerësimi i komunitetit për informacionin në lidhje me mbrojtjen nga dhuna është negativ, nërsa ai i përfaqësuesve të pushtetit vendor është pozitiv. Në Shushicë, palët ndajnë qëndrime të kundërta përse i përket mundësisë që kanë viktimat e dhunës të informohen se kush mund t'i mbrojë nga dhuna. Edhe pse ka informacion mbi OJFtë që ofrojnë ndihmë në zonë, viktimat nuk kërkojnë ndihmë për shkak të turpmit dhe mosnjerrjes së informacionit jashtë familjes. Edhe nëse ankohën ato nuk gjejnë zgjidhje nga dhuna pasi kanë varësi ekonomike nga bashkëshortët dhe familjarë të tjerë. Gratë që nuk kanë pavarësi ekonomike e kanë thujse të pamundur të jetojnë vetëm pa të ardhura, prandaj shteti duhet të ofrojë programe mbështetëse për viktimat e dhunës që ato t'i largohen dhunimit të mëtejshëm. Rastet e dhunës të sjella nga media vetëm sa e kanë përkeqësuar situatën duke i trembur viktimat të tregojnë nga frika e përshkallëzimit të dhunës ndaj tyre. Mungesa e mbrojtjes ligjore dhe mosndëshkimi i agresorëve bën që gratë të mos kenë besim tek institucionet shtetërore se do jenë në gjendje t'i marrin në mbrojtje. OJF si Qendra Aulona dhe Vatra punojnë për ndergjegjesimin për çështjet e dhunës në familje. TLAS prej dy vitesh ofron ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës si dhe ndihmon komunitetin rom të regjistrohet në gjendjen civile.

Në Orikum gjendja duket paksa më e kënaqshme., pasi komuniteti shprehet se informacion ka por gratë nuk arrijnë ta denoncojnë dhunën si pasojë e frikës së ndëshkimit të mëtejshëm në rast se agresori nuk ndëshkohet. Ndërsa përfaqësuesit vendor shprehen se informacioni i dhënë është i dobishëm për të kërkuar ndihmë në rast dhune, por mundësitë nuk shfrytëzohen nga viktimat sepse ato i tremben hakmarrjes së bashkëshortëve të dhunshëm.

Në Novoselë vlerësimi është negativ, pasi nuk ka punonjës që të mbulojë këtë çështje. Dhuna është vecanërisht e pranishme në komunitetin rom të Novoselës. Edhe punonjësit e njësisë pranojnë që niveli i ndërgjegjësimit dhe informimit të grave për dhunën në familje është i ulët dhe se ka mungesë personeli që të mbulojë këtë çështje. Në Qendër vlerësimi i komunitetit është negativ pasi informacioni nuk shërben për zgjidhjen e problemit të dhunës. Duhet struktura në njësi për t'i ofruar ndihmë të menjëhershme viktimës dhe jo të sorrollatet nëpër njësi, bashki e polici. Zyrtarët kanë vlerësim shumë të mirë për informimin në lidhje me dhunën në familje por problemi qëndron tek viktimat që nuk i shfrytëzojnë mundësitë për mbrojtje nga frika e ndëshkimit të mëtejshëm prej ibashkëshortëve.

**Tabela e pikëzimit për informimin mbi mbrojtjen nga dhuna**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>1</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>1</b>	<b>4</b>
	Mesatare	<b>1.2</b>	<b>3.5</b>

Si përfundim, meqë njësitë vendore nuk kanë ngritur pika fokale të barazisë gjinore si mekanizma për zbatimin e ligjit për Dhunën në Familje dhe për ligjin për Barazinë Gjinore, nuk ka as mundësi të ofrojnë informacion për sistemin e referimit të rasteve të dhunës, për nxjerrjen e urdhrat të mbrojtjes dhe trajtimin psiko-mjekësor të viktimave të dhunës. Ndonjëherë ofrohet ndihmë sporadike dhe informale që varet nga njohuritë dhe vullneti i punonjësve vendorë. Ndihmë institucionale nuk ofrohet pasi njësitë vendore janë të patrajnuara për ekzistencën e kuadrit ligjor dhe detyrimet ligjore për zbatimin e tij. Të vetmet që ofrojnë informacion në komunitet janë shoqatat e grave Aulona dhe Vatra. Në lidhje me dhunën gjendja është njësoj, nuk ka përmirësime nga vlerësimi i vitit 2014 krahasuar me vitin 2017.

## **4. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **4.1. Përmbledhje e gjetjeve**

#### ***1. Cilësia dhe eficaenca e shërbimeve publike***

Vlerësimi i banorëve është përgjithësisht më pozitiv se sa ai i zyrtarëve për aksesin tek shërbimet publike dhe për tipologjinë e shërbimeve të ofruara prej njësisë pas reformës territoriale administrative. Për banorët, përvec atyre të Novoselës, shërbimet janë pothuajse të njëjtat, ndërsa për zyrtarët ka një rrudhje të shërbimeve dhe stafit, gjë që ndikon në mundësinë e njësive për të ofruar shërbime cilësore dhe në kohë, sipas nevojave të komunitetit. Më të kënaqurit janë banorët e Qendrës dhe Shushicës. Ndër zyrtarët, nivelin më të ulët të kënaqësisë për shërbimet e shfaqin ata të Novoselës. Vlerësimi i banorëve për aksesin tek shërbimet është pak më pozitiv se sa ai i zyrtarëve.

Sikurse për aksesin tek shërbimet, edhe për cilësinë e tyre, banorët janë disi më të kënaqur se sa zyrtarët publikë. Përvec banorëve të Novoselës, banorët e njësive të tjera e kanë vlerësuar si relativisht të mirë dhe shumë të mirë cilësinë e shërbimeve dhe eficaencën e administratës vendore. Ndërsa zyrtarët janë shprehur më të rezervuar në lidhje me cilësinë, pasi një pjesë e kompetencave lidhur me shërbimet janë marrë nga bashkia e madhe dhe nuk ka pasur investime te mjaftueshme sidomos për ujin e pijshëm, kanalizimet dhe rrugët ndër-fshatëse.

Cilësia e ujit sipas banorëve të njësive vendore le shumë për të dëshiruar, përveçse në qytetin e Orikumit. Banorët e kanë vlerësuar negativisht pushtetin vendor për këtë shërbim dhe kanë pakënaqësi për mosfurnizimin me ujë dhe cilësinë e keqe të ujit të pijshëm. Zyrtarët vendorë janë më pozitivë në vlerësim pasi mendojnë që investimet e nisura në disa ujesjellësa nga Bashkia Vlorë do të sjellin përmirësime të rrjetit dhe të furnizimit me ujë të pijshëm.

Vlerësimi për gjendjen e parqeve shlodhëse, hapësirave argëtuese dhe mjediseve për lojna dhe socializim është krejtësisht negativ. Megjithëse njësitë kanë bërë projekte për parqe, kënde lojnash, qendra komunitare, projektet nuk janë miratuar nga bashkia e për pasojë nuk ka pasur investim në këtë drejtim. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, gjendja është pothuajse e njëjtë për shkak të mungesës së investimeve. Shumica e iniciativave në lidhje me gjelbërimin midis lagjeve dhe mjediseve argëtuese për të vegjlit ndërmerren nga banorët ose biznesi privat, ndërsa njësitë nuk kanë punuar në

këtë drejtim. Gjendja paraqitet me mungesa: të parqeve, mjediseve të blerta, qendrave publike dhe këndeve të lojave për frekuentim nga banorët.

Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të vitit 2014, gjendja e pastrimit të plehrave duket e përmirësuar, përveçse në njësinë Qendër. Plehrat pastrohen rregullisht dhe shërbimi është nënkontraktuar. Gjithësesi, pavarësisht përmirësimit, probleme ka sidomos në fshatrat ku nuk ka vendgrumbullime plehrash dhe ku nuk ka menaxhim mbetjesh. Njësia ka vendosur një grafik për mbledhjen e plehrave. Banorët janë më të ndërgjegjësuar për mbajtjen e mjedisit pastër dhe përdorimin e koshave. Problem ngelet djegia e plehrave në Orikum, pranë lumit ecila shkakton ndotje të ajrit dhe ujit.

Megjithëse ka pasur investime në sistemin e kullimit të ujrave dhe kanalizimeve, banorët dhe zyrtarët nuk janë të kënaqur me cilësinë e tyre. Ata shprehen se ujrat e lumejve dhe përrenjve derdhen të padisiplinuar edhe përmes zonave të banuara dhe në disa raste kanalet janë bllokuar për shkak të ndërtimeve pa leje mbi to. Gjithësesi sistemi është përmirësuar krahasuar me vlerësimin e bërë në vitin 2014 gjatë të cilit u evidentuan probleme të shumta, si : përmbytjet, ujrat e zeza, papastërtitë e hedhura në lumenj dhe kanale kulluese, brigjet e lumenjve të mbuluara nga plehrat, dhe prani të shtuar insektesh si pasojë e ndotjes.

Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm, megjithë investimet në disa rrugë (Mifol, Akerni, Aliban), vlerësimi aktual nuk është më shumë pozitiv, pasi infrastruktura rrugore në fshatra vazhdon të jetë e keqe. Aktualisht janë duke u kryer punime për rrugën lidhëse Babicë e Vogël-Bestrovë.

Cilësia e ndriçimit në këtë vlerësim është e njëjtë me vlerësimin e mëparshëm, pra jo pozitive. Përveç Orikumit, në njësitë e tjera ka probleme të trashëguara me ndriçimin, të cilat nuk janë zgjidhur as këto dy vite.

**Tabela e pikëzimit për shërbimet publike**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi komuniteti</b>	<b>Vlerësimi zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Aksesi dhe tipologjia e shërbimeve publike	<b>3.7</b>	<b>2.7</b>
<b>2</b>	Cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike	<b>3.5</b>	<b>3</b>

<b>3</b>	Cilësia e ujit të pijshëm	<b>1.7</b>	<b>2.7</b>
<b>4</b>	Parqet shlodhese dhe mjedise argëtuese	<b>1</b>	<b>1.2</b>
<b>5</b>	Cilësia dhe shpeshtësia e mbledhjes së plehrave	<b>3</b>	<b>3</b>
<b>6</b>	Kanalizimet	<b>1.7</b>	<b>2</b>
<b>7</b>	Cilësia e infrastrukturës rrugore	<b>2.5</b>	<b>2.7</b>
<b>8</b>	Cilësia e ndriçimit në rrugë	<b>1.5</b>	<b>1.7</b>
	Mesatarja	<b>2.3</b>	<b>2.3</b>

## **2. Demokracia vendore dhe miqeverisja: pjesëmarrja e grave**

Përgjithësisht, përfaqësimi politik i grave në strukturat vendimmarëse është përmirësuar në krahasim me mandatin e shkuar. Përveçse në Shushicë, ku vlerësimi i komunitetit për përfaqësim të balancuar gjinor është negativ, në njësitë e tjera komuniteti shprehet më i kënaqur. Edhe zyrtarët vendorë shprehin një nivel të lartë kënaqësie me përfaqësimin gjinor në vendimmarje dhe administratë, duke evidentuar faktin se grate: janë gati 50% e administratës vendore, përfaqësojnë njësitë në këshillin e bashkisë Vlorë dhe janë emëruar administratore në njësi.

**Tabela e pikëzimit për barazinë gjinore në vendimmarjen publike**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>2</b>	<b>5</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>4</b>	<b>3</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>3</b>	<b>5</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>5</b>	<b>4</b>
	Mesatarja	<b>3.5</b>	<b>4</b>

Gratë kanë aktivizim të lartë në evidentimin dhe zgjidhjen e problemeve të komunitetit. Një rol të çmuar në mbeshtetje të grave ka luajtur shoqëria civile sidoms organizata e gruas AULONA e cila ka ngritur Forumin e Pavarur Qytetar për të angazhuar grate në proceset konsultative me bashkinë dhe njësitë administrative të Vlorës. Partitë politike tregojnë më shumë interes për angazhimin e grave në fushatat zgjedhore, ndërsa në periudha ndër-zgjedhore i përfshijnë pak ose aspak (në fshatra) duke bërë që grate të mos kenë zë në strukturat partiake.

### 3. Zhvillimi ekonomik vendor

Zhvillimi ekonomik i zonës paraqitet mesatarisht i kënaqshëm. NJA vuajnë nga papunësia si pasojë e mungesës së veprimtarisë prodhuese industriale, veprimtarisë së pakoordinuar bujqesore dhe sektorit të vogël të shërbimeve. Megjithatë, zona ka potencial zhvillimi ekonomik sepse ndodhet buzë detit dhe banorët përfitojnë nga sezoni turistik i verës. Edhe pse e kufizuar në kohë, kjo veprimtari siguron të ardhura mesatare për familjet që e ofrojnë këtë shërbim. Gjithashtu, një pjesë e të ardhurave sigurohen nga remitancat e emigrantëve, të cilat edhe pse kanë rënë vazhdojnë të jenë burim për familjet e origjinës. Në disa fshatra gjendja ekonomike është e nivelit mesatar, pasi banorët janë pronarë tokash dhe merren më veprimtari prodhuese bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu, disa prej tyre kanë krijuar ferma dhe mbarështojnë bagëti, kultivojnë drith, vreshta, e pemë frutore. Përveç këtyre kulturave, popullsia e zonës kultivon ullinj të cilët i shet edhe si vaj. Pak fshatra paraqesin një gjendje të dobët ekonomike, si: Narta, Zvërneci dhe Panajaja, terreni I të cilave nuk është i përshtatshëm për mbjelljen e kulturave bujqësore dhe ku banorët nuk kanë mundësi të investojnë në teknologji moderne të shfrytëzimit të tokës për bujqësi. Popullsia rurale ka nivel mesatar të ardhurash prej: punëve bujqësore, turizmit veror dhe emigracionit. Duke qenë gjeografikisht afër qytetit të Vlorës, fshatrat kanë mundësi për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale në qytet.

**Tabela e pikëzimit për szhvillimin ekonomik**

Nr	Njësia administrative	Vlerësimi komuniteti	Vlerësimi zyrtarët vendorë
1	<i>Perkujdes social për fëmijët dhe shkollat</i>	2.5	3
2	<i>Ndihma ekonomike për gratë e papuna</i>	2.7	3.7
3	<i>Nxitja e punësimit</i>	2.2	1.2
4	<i>Gjendja ekonomike e zonës</i>	1.2	1.7
5	<i>Shërbimet vendore për formimin profesional të vajzave dhe grave punëkërkuese</i>	2.5	3.5
	<b>Mesatarja</b>	<b>2.2</b>	<b>2.62</b>

### 4. Te drejtat e grave në nivel vendor

Meqë njësitë vendore nuk kanë ngritur pika fokale të barazisë gjinore si mekanizma për zbatimin e ligjit për Dhunën në Familje dhe për ligjin për Barazinë Gjinore, nuk ka as mundësi të ofrojnë informacion për



sistemin e referimit të rasteve të dhunës, për nxjerrjen e urdhrin të mbrojtjes dhe trajtimin psikomjekësor të viktimave të dhunës. Ndonjëherë ofrohet ndihmë sporadike dhe informale që varet nga njohuritë dhe vullneti i punonjësve vendorë. Ndihmë institucionale nuk ofrohet pasi njësitë vendore janë të patrajnuara për ekzistencën e kuadrit ligjor dhe detyrimet ligjore për zbatimin e tij. Të vetmet që ofrojnë informacion në komunitet janë shoqatat e grave Aulona dhe Vatra. Në lidhje me dhunën gjendja është njësoj, nuk ka përmirësime nga vlerësimi i vitit 2014 krahasuar me vitin 2017.

**Tabela e pikëzimit për dhunën në familje**

<b>Nr</b>	<b>Njësia administrative</b>	<b>Vlerësimi nga komuniteti</b>	<b>Vlerësimi nga zyrtarët vendorë</b>
<b>1</b>	Shushicë	<b>1</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	Orikum	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	Novoselë	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>4</b>	Qendër	<b>1</b>	<b>2</b>
	Mesatare	<b>1.2</b>	<b>2.5</b>

## **4.2. REKOMANDIMET**

### **1. Shërbimet publike**

Banorët vlerësojnë përmirësimet në infrastrukturën rrugore të njësive administrative. Megjithatë ata kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në infrastrukturën rrugore të fshatrave, në lagjet e fshatrave dhe rrugët ndërlidhëse midis fshatrave.

Banorët vlerësojnë investimet në sistemin e ndriçimit, por kërkojnë të punohet më shumë për ndriçimin e rrugëve kryesore, shesheve dhe rrugëve në brendësi të lagjeve të fshatrave.

Për shërbimin e pastrimit rekomandohet të rritet cilësia e pastërtisë, rregullsia e mbledhjes së plehrave, caktimi i vendgrumbullimit të plehrave në fshatra dhe vendosja e koshave të plehrave.

Për shërbimin e gjelbërimit banorët mendojnë se duhet përmirësuar manazhimi i hapësirës duke krijuar parqe shlodhese dhe mjedise të gjelbëruara për qëndrimin e banorëve sidomos fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet rekomandohet të përmirësohen duke bërë investime në ujësjellës për furnizimin me ujë të pijshëm si dhe të shtohet koha e furnizimit me ujë në stinën e verës që përkon me sezonin turistik. Kanalizimet e ujrave të zeza duan ndërhyrje urgjente për të mos u përzier me ujrave të bardha. Kanalet vaditëse dhe kulluese duhen mirembajtur për të mundësuar vaditjen e kulturave bujqësore dhe për të shmangur përmytjet. Për parandalimin e përmytjeve rekomandohet vënia në punë e hidrovorëve.

### **2. Demokracia vendore dhe mirëqeverisja: pjesëmarrja e grave**

Rekomandohet të rritet kontakti mes njësive dhe grave dhe vajzave të zonës. Rekomandohet përdorimi i buxhetimit me pjesëmarrje dhe buxheti gjinor për të gjitha njësitë administrative.

Rekomandohet zbatimi ligjor për konsultimin, informimin dhe njoftimin publik të qytetarëve.

Rekomandohet nxitja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimarrjen publike.

### **3. Zhvillimi ekonomik**

Bashkia e Vlorës të konsultohet me njësitë dhe banorët e tyre për strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe planifikimin e buxhetit të bashkisë për investimet.

Për nxitjen e punësimit të grave dhe vajzave punëkërkuese rekomandohet promovimi i punës së dorës dhe produkteve artizanale të grave të zonës.

Rekomandohet që vajzat dhe gratë e papuna të ndjekin kurset e formimit profesional të mundësuar nga bashkia.

Rekomandohet thithja e investimeve nga biznesi vendas dhe i huaj dhe ngritja e industrisë fasone për punësimin e grave dhe vajzave.

Rekomandohet krijimi i fondit të mbështetjes së grave fermere dhe kooperativeve të tyre në bazë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Rekomandohet të bëhet transparencë për taksat e mbledhura nga bashkia për përdorimin e tyre lidhur me investimet në njësi administrative.

Për nxitjen e punësimit të nënave me fëmijë të vegjël, njësitë duhet të bashkëpunojnë me bashkinë për ngritjen e çerdheve dhe përmirësimin e kushteve fizike në kopshte, në mënyrë që të çlirohet koha fizike e nënave dhe të bëhet një balancë më e mirë kohore mes rolit të përkujdesit dhe punësimit.

#### **4. Të drejtat e grave**

Rekomandohet që njësitë të bashkëpunojnë me pikën fokale të barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna në bashki si dhe me OJFte e grave aktive në Vlorë.

Rekomandohet që bashkia të ofrojë mbrojtje efektive për viktimat e dhunës në familje duke ngritur sisteme referimi në njësite administrative dhe duke emëruar personel për dhunën në familje.

Për minimizimin e dhunës me bazë gjinore rekomandohet që njësitë të bashkëpunim me bashkinë dhe organizata lokale të ndërmarrin fushata ndërgjegjësuese për të luftuar stereotipet gjinore dhe mendësitë patriarkale që inkurajojnë dhunën ndaj grave.

## V. SHTOJCA

Skeda e vleresimit

### SKEDA E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS NGA KOMUNITETI

Bashkia Vlore

Njesia Administrative \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_



Komuniteti do te pyetet lidhur me sherbimet e meposhteme, te japin mendimin e tyre lidhur me situaten aktuale si dhe te bejne nje krahasim me vitin 2014, pra nese situata ka ardhur ne permiresim, keqesim apo eshte gjendje stacionare.




ÇËSHTJA	Treguesi i Performancës	Pikët	Arsyet/Shpjegimet
Sherbimet ndaj qytetareve	Numri i sherbimeve te ofruara nga NJA/Bashkia		
	Cilesia e sherbimeve te ofruara nga NJA/Bashkia duke e krahasuar me vitin 2014 para Reformes Administrative Territoriale		
Pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë politik dhe vendimmarrës	1. Pjesëmarrja në vendimmarrjen publike të grave dhe vajzave		
	2. Përfshirja e grave dhe vajzeve në komisione zgjedhore, keshillimore & procesin vendimmarrës		
Politikat për përmirësimin e gjendjes ekonomike	Cilesia e cerdheve publike		
	Cilësia e infrastrukturës e kopshteve publike dhe shkollave		
	Sa mbeshtetje per ndihmë ekonomike marrin grate dhe vajzat aplikante?		
	Sa punon nja/bashkia per te nxitur punesimin?		
	Ne cfare shkalle e renditni gjendjen ekonomike ne komunitetin tuaj? Nga 1 ne 5		
	Shërbimet vendore që ndihmojnë formimin profesional të grave te papuna		

<b>Politikat për shërbimet sociale, kushtet shëndetësore dhe arsimimin</b>	1-Cilësia e ujit të pijshëm		
	2-si është situata e parqeve shlodhese dhe hapësirave të gjelbra		
	3-Cilësia dhe shpeshtësia e mbledhjes së plehrave		
	4-Mirembajtja e lumit/kanaleve nga papastërtitë e shumta që sjell uji/ dalja e lumit nga shtrati		
	Probleme te tjera		
	5-Cilësia e infrastrukturës rrugore		
	6-Cilësia e ndriçimit në rrugë		
<b>Politikat kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave</b>	7-Kënd lojrash për fëmijët dhe qendra sociale		
	Roli i NJA tuaj për të mbështetur një grua/vajze që peson dhunë. Egzistenca e strukturave për denoncimin e dhunës në familje.		
	Informimi i grave mbi njësitë mbështetëse ku duhet të drejtohen në rast se përjetojnë dhunë.		

### VLERËSIMI ME PIKË

#### Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit

Kriteret		Pikëzimi
Nuk ofrohet asnjë shërbim nga pushteti vendor		<b>1</b> Shumë keq
Ofrohet shërbimi nga pushteti vendor, por cilësia është e dobët		<b>2</b> Keq

Ofrohet shërbimi nga pushteti vendor dhe është i buxhetuar në buxhetin vendor		3 Ok (mesatar)
Ofrohet shërbimi dhe ka buxhet të konsiderueshëm për investime të mëtijshme për këtë shërbim		4 Mirë
Ofrohet shërbimi dhe me cilësi të lartë		5 Shumë mirë

**SKEDA E VETEVLERËSIMIT TË PERFORMANCËS NGA PERFAQESUES TE PUSHTETIT LOKAL . Bashkia Vlore**

Njesia Administrative \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_






ÇËSHTJA	Treguesi i Performancës	Pikët	Arsyet/Shpjegimet
<b>Sherbimet ndaj qytetareve</b>	Numri i sherbimeve te ofruara nga NJA/Bashkia		
	Cilesia e sherbimeve te ofruara nga NJA/Bashkia duke e krahasuar me vitin 2014 para Reformes Administrative Territoriale		
<b>Pjesëmarrje dhe përfaqësim i barabartë politik dhe vendimmarrës</b>	1. Pjesëmarrja në vendimmarrjen publike të grave dhe vajzave		
	2. Përfshirja e grave dhe vajzeve në komisione zgjedhore, keshillimore & procesin vendimmarrës		
<b>Politikat për përmirësimin e gjendjes ekonomike</b>	Cilesia e cerdheve publike		
	Cilësia e infrastrukturës e kopshteve publike dhe shkollave		
	A shihen me prioritet per <b>ndihmë ekonomike</b> grate dhe vajzat kryefamiljare?		
	Sa punon NJA/bashkia per te nxitur <b>punesimin</b> ? Konkretisht		
	Ne cfare shkalle e renditni <b>gjendjen ekonomike</b> ne komunitetin tuaj? Nga 1 ne 5		

	A ka shërbime vendore që ndihmojnë <b>formimin profesional</b> të grave te papuna?		
	Si po ecen puna me <b>menaxhimin e tokës</b> ?		
<b>Politikat për shërbimet sociale, kushtet shëndetësore dhe arsimimin</b>	1-Cilësia e ujit të pijshëm		
	2-si është situata e parqeve shlodhese dhe hapësirave të gjelbra		
	3-Cilësia dhe shpeshtësia e mbledhjes së plehrave		
	4-Mirembajtja e lumit/kanaleve nga papastërtitë e shumta që sjell uji/ dalja e lumit nga shtrati		
	5-Cilësia e infrastrukturës rrugore		
	6-Cilësia e ndriçimit në rrugë		
	Probleme te tjera me te cilat ju punoni?		
	7-Kënd lojrash për fëmijët dhe qendra sociale		
<b>Politikat kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave</b>	Roli I NJA tuaj per te mbeshtetur nje grua/vajze qe peson dhune. Egzistenca e strukturave per denoncimin e dhunës në familj.		
	Informimi i grave mbi njësitë mbështetëse ku duhet të drejtohen në rast se përjetojnë dhunë.		

--	--	--	--

## VLERËSIMI ME PIKË

### Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit

Kriteret		Pikëzimi
Nuk ofrohet asnjë shërbim nga pushteti vendor		<b>1</b> <b>Shumë keq</b>
Ofrohet shërbimi nga pushteti vendor, por cilësia është e dobët		<b>2</b> <b>Keq</b>
Ofrohet shërbimi nga pushteti vendor dhe është i buxhetuar në buxhetin vendor		<b>3</b> <b>Ok (mesatar)</b>
Ofrohet shërbimi dhe ka buxhet të konsiderueshëm për investime të mëtejshme për këtë shërbim		<b>4</b> <b>Mirë</b>
Ofrohet shërbimi dhe me cilësi të lartë		<b>5</b> <b>Shumë mirë</b>